

RAPORT VJETOR 2019

KOMITETI I HELSINKIT
PËR TË DREJTAT E NJERIUT

RAPORT VJETOR I KOMITETIT TË HELSINKIT PËR TË
DREJTAT E NJERIUT PËR VITIN 2019



Botues:

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut,
i përfaqësuar nga kryetari i Këshillit drejtues,
Prof. Dr. Gordan Kallajxhiev

Redaktor:

Uranija Pirovska

Përktheu:

Shenasi Jaji

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

342.72/.73(497.7)"2019"(047)

347.96/.99.047(497.7)"2019"(047)

RAPORT vjetor i komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut
për vitin 2019 / [redaktor Uranija Pirovska ; përktheu Shenasi Jaji]. -
Shkup : Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut, 2020. - 87 стр. :
илустр. ; 26 см

ФУСНОТИ КОН ТЕКСТОТ

ISBN 978-608-4790-72-3

а) Човекови права - Македонија - 2019 - Извештаи б) Правосуден систем -
Реформи - Македонија - 2019 - Извештаи
COBISS.MK-ID 52113669

PËRMBAJTJA

5	HYRJE
9	SISTEMI GJYQËSOR
20	TRAJTIMI I BARABARTË
26	GJUHA E URREJTJES
33	VEPRA NGA URREJTJA
39	INSTITUCIONE TË MBYLLURA
43	KATEGORI TË RREZIKUARA
49	TË DREJTAT E PUNËTORËVE
62	PUNONJËSET NË INDUSTRIJË E TEKSTILIT
68	BARAZIA GJINORE
76	NDIHMJA JURIDIKE FALAS
81	QENDRA PËR MBËSHTETJE LGBTI
85	BARAZIA GJINORE NË SPORT

HYRJE

Në vitin që Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut shënoi 25 vjetorin e themelimit të tij, një nga ngjarjet më të ndritura për t'u theksuar është mbajtja e suksesshme e Paradës së parë të krenarisë, si një hap i madh përpara në betejën për trajtimin e barabartë të njerëzve të komunitetit LGBTI në shoqërinë tonë. Ky komunitet, si dhe grupet dhe qytetarët e tjerë të marginalizuar, në vitin 2019 përfituan edhe nga Ligji i ri për mbrojtje dhe parandalim nga diskriminimi, megjithëse miratimit të këtij ligji i parapriu një nga proceset më të turpshme të zvarritjes dhe sabotimit nga ana e disa subjekteve të caktuara politike, si nga pushteti ashtu edhe nga opozita. Zgjatja e masave të reja për mbrojtje juridike vazhdoi dhe më pas, me dështimin e formimit të Komisionit të ri për mbrojtje nga diskriminimi.

Në ndërkohë, vazhdoi diskriminimi sistematik ndaj romëve, pothuajse në të gjitha sferat shoqërore, ata edhe më tej po ballafaqohen me vështirësi në ushtrimin e të drejtave të tyre. Sa i përket personave me aftësi të kufizuara, u rivendos një model i ri i vlerësimit funksional të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Hapat pozitivë që i ndërmorri shteti për përfshirjen e këtyre fëmijëve në arsimin e rregullt, në praktikë hasën në problem për shkak të mungesës së asistentëve arsimorë dhe personalë. Me sukses më të madh u realizuan përpjekjet për zbatimin e deinstitutionalizimit – duke i transferuar të gjithë fëmijët nga institucionet e mëdha në shtëpi grupesh të vogla dhe në familje strehuesish.

Edhe përkundër lëvizjeve pozitive në disa fusha të caktuara, u intensifikuan fenomenet negative siç janë gjuha e urrejtjes, që kulminoi gjatë kohës së lajmeve dhe ngjarjeve të polarizuara. Si motive kryesojnë përkatësia etnike, orientimi seksual dhe bindja politike. Në rritje janë edhe veprat nga urrejtja të regjistruara nga ana e Komitetit, por institucionet edhe më tej po dështojnë t'i trajtojnë si të tilla, duke i anashkaluar elementet e anshmërisë.

Komiteti i Helsinkit si pjesë e grupit Bluprint për monitorimin e reformave në sistemin gjyqësor ishte aktor aktiv në proceset reformuese edhe pse për një prej çështjeve më të rëndësishme – zgjidhjen e statusit të PSP-së, propozimet tona nuk u futën në asnjërin prej versioneve të projektligjit. Situata kulminoi me arrestimin e prokurores speciale Janeva, në gusht të vitit 2019, me çrast ndaloi së ekzistuari edhe PSP-ja, kurse kompetencat kaluan në prokurorinë e rregullt. Në ndërkohë, disa prej lëndëve të inicuar nga PSP-ja u parashkruan.

Vlerësimi i Komisionit Evropian në raportin e tij për vitin 2019 është se vendi ka treguar përkushtim të vazhdueshëm në përmirësimin e sistemit gjyqësor dhe zbatimin e kornizës së re juridike është një bazament i fortë për një përparim të vazhdueshëm, por që të gjithë institucionet gjyqësore duhet që përmes përpjekjeve të shtuara të kontribuojnë në kthimin e besimit të qytetarëve te gjyqësori. Megjithatë, sa i përket procesit të reformave, pati efekt demotivues vendimi i tetorit i Këshillit Evropian që t'i rikthehet çështjes së zgjerimit në maj të

vitet 2020, pas së cilit vendim u miratua vendimi për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare.

Sa i përket të drejtave të punëtorëve, dyfishi i rasteve që i regjistruam dhe mbulimi dukshëm më i madh i punëtorëve në vitin 2019 është rezultat i veprimit aktiv të Komitetit për të rritur ndërgjegjësimin e punëtorëve dhe për t'i informuar ata për ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. Si problem i madh mbetet vullneti i pamjaftueshëm i Inspektoratit Shtetëror të Punës, i cili ende nuk i ka zbatuar rekomandimet e Komitetit bazuar në monitorimin e rregullt të punës së tij- prandaj punëtorët nuk kanë mbrojtje përkatëse institucionale sa i përket shkeljes së të drejtave të tyre dhe nuk ka përparim as në sigurinë dhe shëndetin në punë. Komiteti, si pjesë e grupit të punës për hartimin e Ligjit të ri për marrëdhëniet e punës, arriti që t'i adresojë propozimet dhe idetë e punëtorëve në industrinë e tekstilit- kështu, ato për herë të parë u përfaqësuan në procesin e miratimit të politikave dhe ligjeve.

Vazhdoi edhe beteja për barazi gjinore. Në muajin maj u miratua Ligji për ndërprerjen e shtatzënisë ku u largua problemi i shkaktuar nga ligji paraprak i cili në shkallë të jashtëzakonshme e pamundësonte qasjen te aborti. Këtë vit u formua grup pune për hartimin e Ligjit të ri për mundësi të barabarta të grave dhe burrave. U bënë arritje të konsiderueshme sa i përket përmbushjes së qëllimeve dhe aktiviteteve të përcaktuara nga Plani kombëtar i veprimit për zbatimin e Konventës së Stambollit 2018-2023 (PKV), në veçanti me themelimin e tri qendrave për strehimin e viktimave të dhunës seksuale. Megjithatë, një prej akteve kryesore – Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhunës në familje, për shkak të shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare nuk u vendos për votim në Kuvend. Si një ndër pikat më problematike, kjo bazuar në dëshmitë personale të viktimave, Komiteti konstatoi shkallë të lartë të mungesës së senzibilizimit të nëpunësve të QPS-së dhe MPB-së, të gjykatësve, prokurorëve etj, sjellja e të cilëve kontribuoi në mënyrë të konsiderueshme në viktimizimin e dyfishtë të viktimave. Nga ana tjetër, sa i përket përfaqësimit ndërkombëtar, Komiteti i Helsinkit këtë vit parashtrroi kundërshtim në Komitetin CEDAW, që paraqet komunikimin e parë të Republikës së Maqedonisë së Veriut me Komitetin CEDAW. Poashtu, këtë vit e shënoi edhe aktivizmi i fuqizuar dixhital përmes platformës së parë feministe në gjuhën maqedonase, Meduza, në veçanti përmes fushatës #PseNukDenoncova, e cila kishte për qëllim ndërprerjen e heshtjes në lidhje me dhunën seksuale.

Dhe përfundimisht, pas adresimeve shumëvjeçare për mangësitë në Ligjin për ndihmë juridike falas, në vitin 2019 u miratua ligj i ri, i cili përfshin një diapazon më të gjerë qytetarësh që i plotësojnë kushtet për marrjen e ndihmës juridike falas. Komiteti i Helsinkit e monitoron në mënyrë sistematike procesin e zbatimit të Ligjit të ri dhe njëra ndër vërejtjet kryesore është

domosdoshmëria për aftësim profesional të të gjithëve që kontribuojnë në ushtrimin e të drejtave të qytetarëve.



SISTEMI GJYQËSOR

REFORMAT NË SISTEMIN GJYQËSOR

Komisioni Evropian në Raportin e tij për vitin 2019 dha vlerësime pozitive për përparimin e vendit në zgjidhjen e „Prioriteteve urgjente reformuese“ dhe rekomandimeve të Komisionit të Venedikut dhe Grupit të lartë të ekspertëve për çështje sistimore në lidhje me sundimin e së drejtës. Raporti vlerësoi se vendi ka treguar përkushtim të vazhdueshëm në përmirësimin e sistemit gjyqësor dhe zbatimi i kornizës së re juridike është një bazament i fortë për një përparim të vazhdueshëm. Komisioni Evropian në raportin e tij thekson se përkundër miratimit të ndryshimeve ligjore, të gjithë institucionet gjyqësore duhet që përmes përpjekjeve të shtuara të kontribuojnë në kthimin e besimit të qytetarëve te gjyqësori.

Në vitin e ardhshëm, vendi në veçanti duhet të:

- vazhdojë me zbatimin e strategjisë për reforma në sistemin gjyqësor, duke i dhënë përparësi zhvillimit të strategjisë për burime njerëzore dhe përmirësimin e sistemit të informacionit për menaxhim automatik të lëndëve gjyqësore (AKMIS), që të sigurohet se është plotësisht funksional dhe i sigurt;
- sigurojë zbatim të qëndrueshëm të rregullave të reja për emërimin, avancimin, procedurat disiplinore dhe shkarkimin e gjykatësve dhe të dëshmojë se pavarësia e sistemit gjyqësor po respektohet në të gjithë nivelet, duke e mbrojtur plotësisht nga rreziku i përfshiresa së politikës;
- zbatojë në përpikmëri kornizën e re juridike në lidhje me reformën e Këshillit gjyqësor dhe të miratojë një reformë për Këshillin e prokurorëve publikë;

Megjithatë, me shumë gjasë edhe viti 2019 kaloi me turbulenca në fushën e gjyqësorit dhe sundimit të ligjit. Në pjesën më të madhe, fokusi ishte përqëndruar në statusin e Prokurorisë speciale publike dhe integrimin e saj në sistemin e rregullt të Prokurorisë publike. Sa i përket sistemit gjyqësor, Grupi Bluprint nuk ishte i përfshirë në grupin e punës përgjegës për hartimin e projekt-ligjit për prokurorinë publike, por në disa raste e theksoi përkushtimin e tij se **PSPJ-ja si institucion duhet të vazhdojë të funksionojë në kuadër të sistemit të prokurorisë publike**, në përputhje me rregullat dhe organizimin hierarkik, por në të njëjtën kohë të shndërrohet në prokurori publike në nivel të njëjtë me PPNKKO dhe me mandat për të ndjekur penalisht korrupsionin e lartë. Dëshmitë materiale video dhe audio është e domosdoshme që edhe më tej të përdoren në procese, sipas vlerësimit të gjykatësve. Lëndët nën kompetencë të PSP-së duhet të vazhdojnë dhe të kenë epilogun e tyre. Propozimet e Grupit Bluprint nuk u përfshinë në asnjë prej versioneve të projekt-ligjit që u publikuan nga Ministria e Drejtësisë. Tensioni rreth PSP-së kulminoi në gusht të vitit 2019 me rastin e arrestimit të Prokurores speciale publike dhe ngritjes së aktakuzës për kryerjen e dy veprave penale – Marrje ryshfeti (shpërblim) për ndikim të jashtligjshëm dhe Keqpërdorim i pozitës dhe autorizimit zyrtar. Pas kësaj periudhe PSP-ja defakto ndaloi së ekzistuari, kurse kompetencat u „transferuan “ në prokurorinë e rregullt publike. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, disa prej lëndëve që ishin ngritur nga PSP-ja u **parashkruan**.

Si demotivim plotësues ishte edhe vendimi i Këshillit Evropian në tetor të vitit 2019, që çështja e përafrimit të Maqedonisë së Veriut të rikthehet në muajin maj 2020, duke shpërfillur rekomandimin e Komisionit Evropian që dha dritën jeshile për hapjen e bisedimeve me vendin tonë. Pas një vendimi të tillë të Këshillit Evropian, udhëheqësit e partive politike në muajin prill të vitit 2020 ranë dakord për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, duke e vënë përsëri në pikëpyetje vazhdimësinë e zbatimit të reformave në sistemin gjyqësor.

Komiteti i Helsinkit së bashku me organizatat partnere të Grupit Bluprint, me përpikmëri e ka monitoruar tërë procesin e zbatimit dhe implementimit të reformave strategjike të gjyqësorit, në veçanti nga aspekti i respektimit të kornizës kohore të parashikuar për zbatimin e reformave, përfshirjen e sektorit civil, palët e interesuara, publikun dhe transparencën e tërë procesit. Përfundimi i përgjithshëm që mund të nxirret për të gjithë procesin e zbatimit të masave dhe aktiviteteve, të parashikuara në Strategjinë për reforma në sistemin gjyqësor, është se i gjithë procesi u vonua në mënyrë të konsiderueshme dhe se për disa segmente nuk kishte përfshirje të mjaftueshme të shoqërive civile, me çrast mund të konstatohet se i gjithë procesi i reformës ishte pjesërisht transparent.

Është me rëndësi të përmendet se në vitin 2019 hynë në fuqi, respektivisht u votuan shumë ligje reformuese, ndër to edhe ndryshimet dhe plotësimet e Kodit penal, Ligjit për këshillin gjyqësor, Ligjit për këshillin e prokurorëve publikë, Ligjit për kundërvajtje, Ligjit për konflikte administrative, Ligjit të noteriatit, Ligjit të përmbarrimit dhe Ligjit për ndihmë juridike falas.

ISITË E PËRFSHIRA NË LIGJET E MIRATUARA DHE NË NDRYSHIMET LIGJORE

- **Kodi Penal**

Në fund të vitit 2018 u miratua Ligji për ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Penal të RMV-së, i cili hyri në fuqi në janar të vitit 2019¹. Disa prej intervenimeve të parashikuara në Ligj ishin pozitive dhe ishin ndryshime thelbësore në materien penale-juridike, veçanërisht ndryshimet e shumëpritura për ndjekje dhe sanksionim përkatës të veprave penale nga urrejtja, si dhe përfshirja e dispozitave të reja për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe dispozitave për sanksionimin e pengimit të drejtësisë.

Megjithatë, një pjesë e ndryshimeve dhe plotësimeve, pa u arsyetuar si duhet si nga propozuesit, ashtu edhe nga ligjvënësi, lanë hapësirë për spekulime, veçanërisht sa i përket arsyes së vërtetë të miratimit të tyre. Në këtë drejtim, hynë në fuqi ndryshimet dhe plotësimet që i përkasin nenit 40 (Zbutje e dënimit), nenit 275-c (Keqpërdorim i procedurës së thirrjes publike, dhënia e kontratës për furnizim publik ose partneritet publiko-privat) dhe nenit 279-a (Mashttrim tatimor).

- **Ligji për gjykatat**

Me ndryshimet e fundit të Ligjit për gjykatat, për herë të parë zbatohen rekomandimet e plota të Komisionit të Venedikut. Projekt-ndryshimet e këtij ligji u aprovuan nga Komisioni i Venedikut në dhjetor të vitit 2018. Këto ndryshime janë të orientuara në respektimin e rekomandimeve të dhëna në rrethin e tretë të vlerësimit dhe respektimin e masave të përcaktuara në Strategji, të cilat, ndër të tjerat u përshëndetën edhe në Raportin e fundit të Komisionit Evropian për vendin tonë.

Me ndryshimet bëhet riemërimi i emërimit të Gjykatës themelore Shkup 1 – Shkup dhe Gjykatës themelore Shkup 2 – Shkup në Gjykatë themelore penale Shkup dhe Gjykatë themelore civile Shkup dhe zgjerohet kompetenca e gjykatave me kompetencë themelore që të veprojnë me lëndët nga ndihma juridike ndërkombëtare.

¹ Ligji për ndryshime dhe plotësime të Kodit Penal të RM-së, Gazeta Zyrtare e RMV-së 248/2018 i datës 31.12.2018.

Më tej, përsëri u ndryshuan bazat për përgjegjësinë e gjykatësve, në fakt bëhet shkallëzimi i bazave për shkarkim, më saktë për formë më të butë të shkeljes së bazave për shkelje të rëndë disiplinore, gjykatësit mund t'i shqiptohet masë disiplinore. Sa i përket bazave për shkarkimin e gjykatësve merret në konsideratë edhe pesha e shkeljes së kryer dhe faji i gjykatësit.

Në pajtim me rekomandimet e GREKO-s parashikohet një kompetencë për Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut që në seancën e përgjithshme të miratojë Kodin etik për gjykatësit dhe gjykatësit-porotë. Janë ndryshuar kriteret e zgjedhjes dhe avancimit të gjykatësve në pajtim me rekomandimet e Pribe dhe misionit vlerësues të TAIEX për trajnimin e gjykatësve dhe prokurorëve publikë. Në këtë drejtim, pika e vetme për hyrje në sistemin gjyqësor do të jetë Akademia për gjykatës dhe prokurorë publikë. Sipas rekomandimeve të misionit vlerësues të TAIEX i mundësohet një ish-gjykatësi në gjykatë ndërkombëtare, nëse i plotëson kriteret e përgjithshme për zgjedhjen e gjykatësit, të zgjedhet në të gjitha instancat e gjyqësorit. Me këto ndryshime, për herë të parë parashikohet që një gjykatës i zgjedhur për rajonin e një gjykate themelore ose të apelit, pas kalimit të një numri të caktuar vitesh me përvojë të pandërprerë si gjykatës në gjykatën përkatëse, të mund të zgjedhet në një gjykatë themelore ose apeli të një rajoni tjetër.

Sipas përcaktimeve në Strategjinë për reforma në sektorin gjyqësor është parashikuar që gjykatës me përvojë pune deri në 2 vjet të gjykojnë lëndë më të lehta. Në këtë mënyrë do të pamundësohet që gjykatës me përvojë më të pakët pune të gjykojnë lëndë të rënda, sepse më herët kishte raste të tilla me rastin e ndryshimeve të orareve vjetore. Sa i përket dërgimit të gjykatësve në një gjykatë tjetër dhe përcaktimit në një departament tjetër, sipas ndryshimeve në Ligjin për gjykatat, një gjykatës mund të dërgohet në gjykatë tjetër dhe të përcaktohet në një departament tjetër për një periudhë njëvjeçare, por jo më tepër se një herë brenda një periudhe pesëvjeçare. Në këtë drejtim, me propozim të Komisionit të Venedikut futen garancione në rast të dërgimit të gjykatësve në gjykata të tjera dhe përcaktimin e tyre në një nivel më të ulët për shkak të situatave të caktuara. Në ligjin ekzistues parashikohet që gjykatësi mund të dërgohet dhe të përcaktohet më së shumti një vit. Me propozim të Komisionit të Venedikut definohet edhe kufizimi se deri kur do të llogaritet kjo periudhë njëvjeçare. Me zgjidhjen e propozuar dërgimi dhe përcaktimi në departament tjetër do të jetë maksimalisht një herë për një periudhe pesëvjeçare. Me këtë zgjidhje pamundësohet që dërgimi dhe përcaktimi në një departament tjetër të përdoret si formë presioni.

Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për gjykata është parashikuar formimi i Këshillit për koordinim dhe menaxhim me teknologjinë e informacionit dhe komunikimit në institucionet gjyqësore. Këshilli për TIK jep propozim për definimin e prioriteteve të politikave dhe koordinim

të institucioneve gjyqësore për punën në sistemin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Në strategjinë për reforma në sektorin gjyqësor është parashikuar përgatitja e analizës për rrjetin gjyqësor dhe numrin e gjykatave në vend me qëllim të optimizimit të numrit të gjykatave përmes ndryshimeve në Ligjin për gjykatat. Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për gjykatat, Gjykata themelore në Gjevgjeli, Gjykata themelore në Kavadar dhe Gjykata themelore në Kërçovë nga viti 2020 do të jenë gjykata me kompetenca të zgjeruara. Gjithashtu, në ndryshimet e fundit në Ligjin për gjykatat përfundimisht u saktësuan bazat për ngritjen e procedurës për konstatimin e përgjegjësisë së gjykatësit dhe është bërë një kufizim i detajuar se cilat prej këtyre bazave çojnë drejt shkarkimit të gjykatësit/kryetarit të gjykatës dhe cilat çojnë në shqiptimin e masës së lehtë ose të rëndë dispilnore, kurse procedura për veprim mbi këto baza nga ana e Këshillit gjyqësor është shtjelluar imtësisht në Ligjin e ri për Këshillin gjyqësor.

- **Ligji për Këshillin gjyqësor**

Në ligjin e ri, për herë të parë janë parashikuar dispozita me të cilat përshkruhen bazat e përgjegjësisë dhe procedurat për konstatimin e përgjegjësisë kundër anëtarëve të Këshillit gjyqësor. Për më tepër, përfundimisht u saktësuan edhe kriteret mbi të cilët vlerësohen gjykatësit me rastin e avancimit të tyre, me çrast raporti i kriterëve cilësorë është rritur jashtëzakonisht në krahasim me kriteret kuantitativë.

Është saktësuar dhe sqaruar procedura për konstatimin e përgjegjësisë së gjykatësve dhe kryetarëve të gjykatave. Kryetari i Gjykatës Supreme, si anëtar i Këshillit Gjyqësor, nuk do të ketë të drejtë vote.

Anëtarët e Këshillit Gjyqësor nga rradha e juristëve të dalluar nuk mund të zgjedhen nga rradha e gjykatësve dhe prokurorëve publikë.

Në procedurën për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga rradha e gjykatësve për herë të parë do të marrin pjesë edhe organizatat relevante të shoqërisë civile në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave të njeriut.

Gjatë zgjedhjes së gjykatësve në gjykatat themelore, për herë të parë Këshilli Gjyqësor do të zbatojë intervista me kandidatët, që vlerësohet me 10% të pikëve që do t'i fitojë kandidati.

Gjykatës në gjykatat themelore mund të përzgjidhet edhe një gjykatës nga ndonjë gjykatë tjetër themelore, nëse nuk kanë aplikuar kandidatë nga Akademia për gjykatës dhe prokurorë publikë.

Përfundimisht u saktësuan bazat për ngritjen e procedurës për konstatimin e përgjegjësisë së gjykatësit dhe është bërë një kufizim i detajuar se cilat prej këtyre bazave çojnë drejt shkarkimit të gjykatësit/kryetarit të gjykatës dhe cilat çojnë në shqiptimin e masës së lehtë ose të rëndë disiplinore, kurse procedura për veprim mbi këto baza nga ana e Këshillit gjyqësor është përpunuar imtësisht në Ligjin e ri për Këshillin gjyqësor. Njëherit, janë forcuar edhe kushtet për avancimin e gjykatësve.

- **Ligji për ndihmë juridike falas**

Me miratimin e ligjit u zgjerua edhe fushështirja e përdoruesve të ndihmës juridike falas. Sa i përket fushëveprimit, zgjerimi është vetëm i pjesshëm për faktin se në nenin 22 paragrafi 1 disa çështje ligjore me interes për grupet më të varfra sociale janë përjashtuar nga ndihma juridike falas (çështje në lidhje me shërbimet publike dhe komunale – për shembull, energjia elektrike, uji etj., çështje pronësore në procedurën administrative etj.).

- **Ligji për konfliktet administrative**

Nevoja për miratimin e një ligji plotësisht të ri për konflikte administrative doli nga kërkesat e qytetarëve dhe personave juridikë për të gëzuar mbrojtje më efikase, efektive dhe ekonomike administrativo-ligjore në ushtrimin e të drejtave të tyre si dhe në rastet kur u lindin detyrime nga ana e institucioneve publike.

Ligji për konfliktet administrative në muajin mars 2019 u votua me shumicë prej dy të tretash të deputetëve. Për shkak të mosnënshkrimit të dekretit për shpalljen e Ligjit për konfliktet administrative nga ana e kryetarit asokohe të RMV-së dhe për shkak të zgjedhjeve të parakohshme, vonoi edhe hyrja e tij në fuqi. Më në fund, më 17 maj 2019, dekretin e nënshkroi kryetari i ri i RMV-së. Ligji për konfliktet administrative do të hyjë në fuqi në ditën e tetë pas shpalljes në „Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“, kurse do të fillojë të zbatohet një vit nga dita e hyrjes në fuqi.

Risitë kryesore që i parashikon Ligji i ri për konflikte administrative i cili do të fillojë të zbatohet më 17 maj 2020, janë:

- Zgjerimi i fushështirjes së konfliktit administrativ në pjesën e themelimit të kompetencës së gjykatave administrative që ta vlerësojë ligjshmërinë e akteve përfundimtare që nga natyra e

tyreadministrative, por akte përfundimtare individuale me të cilat vendoset për zgjedhje, emërim dhe shkarkim të bartësve të funksioneve publike të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, institucionet e administratës shtetërore, organizatat e përcaktuara me ligj, institucionet e tjera shtetërore si dhe institucionet e njësisive të vetëqeverisjes lokale. Në fakt, kjo risi u jep një koncept të ri kompetencës së gjykatave administrative nga fakti se me këtë kompetencë gjykatat administrative vihen në pozitë të kontrolluesit të kompetencave dhe diskrecionit kushtetues të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut si dhe Qeverisë së RMV-së, me çka lihet sistemi i deritanishëm i konflikteve administrative që ishte kryesisht i bazuar në vlerësimin e ligjshmërisë së akteve përfundimtare administrative të institucioneve publike.

- Ligji i ri për konfliktet administrative për herë të parë vendos një kufizim të afatit për parashtrimin e padisë kundër heshtjes së administratës. Në fakt, LKA-ja parashikon se në rast të konfliktit administrativ për shkak të heshtjes së administratës, LKA-ja parashikon se paditësi duhet të parashtrijë padinë në afat prej 30 ditëve pas skadimit të afatit të përcaktuar ligjor për miratimin e aktit. Kjo zgjidhje paraqet kufizim të mbrojtjes të parashikuar me LKA-në, sepse obligimi për interpretimin e kësaj dispozite mbetet te qytetarët.

- Ligji i ri parashikon diskutim publik si rregull, me mundësi për përjashtimin e tij.

- Parashikimi i vendimit-model në rastet kur në Gjykatën administrative do të parashtrihen padi kundër më shumë se 20 akteve administrative në të cilat të drejtat dhe detyrimet e paditësve bazohen në një gjendje faktike të barabartë ose të ngjashme dhe që kanë një bazë të njëjtë juridike. Njëherit, parashikohet që Gjykata administrative medoemos të miratojë vendimin-model pas mbajtjes së diskutimit dhe ta publikojë si sentencë e praktikës gjyqësore të gjykatës.

- Parashikimi që të mundësohet veprimi nga ana e gjykatësit-individ në konflikte ku lënda e shprehur në vlerë monetare nuk e tejkalon shumën prej 10.000 euro në kundërvlerë të denarit ose në konflikte ku kontestohen vetëm veprime procesuese në procedurën e miratimit të aktit administrativ. Pas miratimit të LKA-së duhet që të përgatitet metodologjia për përcaktimin e vlerës së konflikteve administrative me qëllim që të caktohet përbërja e gjykatësve për konfliktin konkret administrativ.

- Sigurimi i zbatimit të aktgjytimeve të gjykatave administrative duke shqiptuar gjobë në rast mosrespektimi të vendimeve të gjykatës, në shumën 20% të pagës mujore të personit të autorizuar në institucionin publik.

- Heqja e mundësisë që institucionet publike të përfaqësohen nga Zyra e Avokatisë së Shtetit në procedurën e apelit. Kjo kompetencë i kalon organit publik që ka miratuar aktin administrativ të

kontestuar, i cili duhet të çojë në një menaxhim më ekonomik dhe efikas të procedurës administrative, sepse akti administrativ që kundërshtohet me padi para Gjykatës Administrative do të përfaqësohet nga personi i autorizuar zyrtar i organit publik, i cili në të vërtetë e ka miratuar aktin administrativ, me çka supozohet se zyrtari i autorizuar është më shumë i njoftuar me natyrën e aktit administrativ dhe arsyen e miratimit të tij.

- Ligji i ri parashikon se gjykatat administrative, kur vendosin për shpenzimet e procedurës, veprojnë në përputhje me Ligjin për procedurë kontestimore. Kjo do të thotë se palës në konfliktin administrativ që do të ketë sukses në procedurë do mund t'i kompensohen shpenzimet e procedurës në përputhje me vendimet e gjykatave administrative.

- **Ligji për kundërvajtje**

Ligji për kundërvajtje hyri në fuqi më 25 maj 2019. Në ligjin e ri, si rregull, parashikohet shqiptimi i paralajmërimit para se të shqiptohet gjoba. Në këtë mënyrë është parashikuar përmirësim i efikasitetit të procedurës kundërvajtëse dhe mbrojtje më efektive të qytetarëve. Paralajmërimi do të shqiptohet nëse kundërvajtja është për shkak të mospërbushjes së obligimit të përshkruar ose nëse është shkaktuar dëm, dhe autori para miratimit të aktvendimit për kundërvajtje e ka përmbushur obligimin e përshkruar ose kur kundërvajtja është kryer për herë të parë dhe nuk ka shkaktuar pasoja dëmtuese dhe nuk e ka kanosur interesin publik.

Ligji parashikon ulje të gjobave për personat fizikë për 75%. Me zgjidhjen e re ligjore gjoba minimale për persona fizikë është 15 euro, kurse ajo maksimale 250 euro, në vend të gjobave të deritanishme prej 1.000 euro. Njëherit parashikon edhe ulje të gjobave për personat juridikë, me çrast do të merren parasysh edhe të hyrat e realizuara në vitin paraprak, numri i të punësuarëve dhe sanksionimi paraprak i tyre dhe kundërvajtjet e ngjashme.

Ligji i ri parashikon edhe ndarje ndërmjet ndërmarrjeve të vogla, mesme dhe të mëdha. Për ndërmarrjet e vogla gjoba minimale do të jetë 50 euro, kurse ajo maksimale 2.000 euro. Sa për krahasim, në ligjin e vjetër gjoba maksimale ishte 5.000 euro, që do të thotë se gjobat për ndërmarrjet e vogla ulen për dy herë e gjysmë. Për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, gjoba e shqiptuar minimale do të jetë 250 euro, kurse shuma maksimale e gjobës së shqiptuar nuk mund të jetë më shumë se 10.000 euro.

Për disa kundërvajtje të caktuara nga sfera e konkurrencës, energjetikës, komunikimeve elektronike dhe tregtisë me mallra të ndaluara/kufizuara për përdorim ose në sfera të tjera që janë përafuar ose po përafrohen me legjislacionin e Bashkimit Evropian, mund të shqiptohet gjobë në shumë përqindjeje, por jo më shumë se 10% të të hyrave të personit juridik, të realizuara në vitin paraprak fiskal.

Ligji për kundërvajtje parashikon gjoba më të larta për kundërvajtjet që parashikojnë rrezikshmëri shoqërore, si dhe për ato që janë kundër mjedisit jetësor dhe shkatërrimit të pasurisë kulturore. Parashikohen gjoba më të larta për kundërvajtjet me karakter dhe interes publik nga sfera e tatimeve, doganave, furnizimeve publike, financave publike dhe borxhit publik.

Me ligjin e ri shfuqizohet Komisioni shtetëror për vendimmarrje në shkallë të dytë nga sfera e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës kundërvajtëse. Me ligjin e ri u jepet kompetencë gjykatave të rregullta për numrin më të madh të kundërvajtjeve, dhe kështu gjykatat administrative do të vendosin për numër më të vogël kundërvajtjesh, në krahasuar me gjendjen aktuale ku kompetenca e gjykatave të rregullta dhe gjykatave administrative është e balancuar.

KËSHILLI PËR MONITORIMIN DHE ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR REFORMA NË SISTEMIN GJYQËSOR 2017-2022

Komiteti i Helsinkit, së bashku me anëtarët e tjerë të Grupit Bluprint për sistemin gjyqësor, ka marrë pjesë me përfaqësues të vet në punën e Këshillit për monitorimin e zbatimit të Strategjisë për reformën e sistemit gjyqësor. Komiteti e konsideron pjesëmarrjen dhe punën në këtë këshill si një shembull pozitiv, sepse përmes tij organizatat e shoqërisë civile patën mundësinë të shprehin drejtpërdrejt pikëpamjet dhe perceptimet e tyre për reformat në sistemin gjyqësor para vendimmarrësve, si dhe të bëjnë drejtpërdrejt propozime, të cilat në disa raste edhe u pranuan. Në këtë mënyrë, anëtarët e Grupit Bluprint për gjyqësorin ishin aktorë aktivë në procesin e gjithanshëm të reformës.



БЛУПРИНТ ГРУПА
за реформи во правосудството



TRAJTIMI I BARABARTË

LOJËRA POLITIKE DHE PENGESA PËR LIGJIN PËR PARANDALIM DHE MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI

Viti 2019 ka kaluar në shenjë të pengesave dhe vështirësive në miratimin e Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi dhe joformimit të Komisionit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi. Shteti edhe një herë dështoi në portretizimin, përmirësimin dhe avancimin e plotë të gjendjes me diskriminimin në shoqëri, si një ndër pikat kryesore në pjesën e të drejtave themelore të Kapitullit 23 – Sistemi gjyqësor dhe të drejtat themelore, për aderim në Bashkimin Evropian.

Projekt-ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi ishte dorëzuar në Kuvend në muajin maj të vitit 2018 dhe që atëherë u ballafaqua me pengesa, barriera dhe bllokime të procedurës për miratimin e tij. Disa deklarata skandaloze dhe qëndrime politike të përfaqësuesve të lartë qeveritarë dhe të deputetëve në fillim të vitit vetëm sa konfirmuan se nuk ka ndryshime rrënjësore të qëndrimeve të shumicës së partive politike ndaj grupeve më të marginalizuara të qytetarëve, për të cilët ky ligj duhet të ofrojë mbrojtje. Zëvendëskryeministri Osmani, duke qenë mysafir në emisionin televiziv “Top Tema” në muajin janar dhe

duke diskutuar për risitë që sjell ligji i ri, e karakterizoi komunitetin LGBTI si “kategori kontestuese” dhe deklaroi se futja në mënyrë eksplicite e orientimit seksual dhe identitetit gjinor në projekt-ligj është një ndër dilemat e shumta që BDI-ja dhe partitë e tjera politike i kanë në lidhje me këtë ligj. Pengesa shtesë për miratimin e Ligjit u bënë edhe nga kryetari i Komisionit të Kuvendit për punë dhe politikë sociale, Vllatko Gjoçev, i cili, sipas deklaratave të deputetes Maja Moraçanin nga DOM, kishte refuzuar që të vë projekt-ligjin në rendin e punës të Komisionit, sepse projekt-ligji kishte qenë “problematik”.

Në shkurt të vitit 2019, qindra organizata të shoqërisë civile, rrjete dhe koalicione organizatash mbajtën një protestë para Kuvendit duke kërkuar miratimin urgjent të Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, i cili asokohe gjendej në procedurë kuvendore për më shumë se tetë muaj.

Projekt-ligji ishte votuar me procedurë të shkurtuar në seancën e Kuvendit, e mbajtur



1 Protestë e organizatave të shoqërisë civile – 28 shkurt 2019

më 11 mars 2019. Por, kryetari asokohe i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gjorgje Ivanov refuzoi të nënshkruante dekretin për shpalljen e Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi dhe ligji ishte kthyer në votim të sërishëm. Ligji u votua përsëri në seancën e Kuvendit, e mbajtur më 16 maj 2019, që të hyjë në fuqi më 23 maj 2019, menjëherë pas nënshkrimit të dekretit për shpalljen e tij nga ana e kryetarit të posazgjedhur të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski.

Komiteti i Helsinkit vazhdoi mbikëqyrjen e procesit të themelimit të Komisionit të ri për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, si kusht fundamental për funksionalitetin e

Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi dhe përmirësimin dhe avancimin e parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi në vend. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut shpalli konkurs publik për zgjedhjen e anëtarëve (komisarë) të Komisionit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi.

Në dhjetor të vitit 2019, Kuvendi pa arsyetim të shkaqeve mbi anulimin e konkursit publik, në mënyrë jotransparente vendosi që të shpall përsëri një konkurs të ri për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi. Kuvendi asnjëherë nuk doli me një shpjegim dhe arsyetim zyrtar pse pothuajse katër muaj

nuk ishin zgjedhur anëtarët e rinj të Komisionit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi dhe pse qytetarët akoma nuk e kanë në dispozicion këtë mekanizëm mbrojtës. Nga shpallja e konkursit të ri deri në kohën e shpërndarjes së Kuvendit më 16 shkurt 2020, në prag të zgjedhjeve parlamentare, deputetët nuk arritën të zgjedhin anëtarët e rinj të Komisionit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, përkundër thirrjeve të shumta për zbatimin e procesit të zgjedhjes së anëtarëve të rinj në një mënyrë transparente, duke marrë parasysh cilësinë e

kandidatëve të zgjedhur, me një detyrim që përbërja e këtij organi të shprehë përbërjen e shoqërisë në tërësi. Ky lëshim, mosinteresim dhe pasivitet i deputetëve do të thotë që qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të mbeten pa Komision për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi për të paktën 8 muaj, nga momenti i shpërbërjes së përbërjes së mëparshme të Komisionit e deri në përfundimin e zgjedhjeve parlamentare në prill të vitit 2020, çka paraqet shkelje serioze të qasjes në drejtësi dhe parandalimit në rastet e diskriminimit.


NDIHMË JURIDIKE PËR VIKTIMAT E DISKRIMINIMIT

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në vitin 2019 e monitoroi vazhdimisht situatën në fushën e diskriminimit në tërë territorin e vendit, me qëllim parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, duke ofruar ndihmë juridike për viktimat e diskriminimit, duke informuar publikun për rastet e diskriminimit, veprimet dhe efektivitetin e mekanizmave për mbrojtje ndaj diskriminimit.

Këtë vit, Komiteti i Helsinkit punoi në ndërtimin e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile për ofrimin e ndihmës juridike falas në raste diskriminimi dhe zbatimin e testimit të situatës, si metodë për argumentimin e diskriminimit.

Sa i përket rasteve të dokumentuara, përveç për denoncimet e pranuar për raste diskriminimi, Komiteti ka vepruar edhe në rastet që i ka regjistruar përmes monitorimit të mediave, rrjeteve sociale, konkurseve për punësim dhe përmes monitorimit të situatës në shoqëri, respektivisht politikave dhe praktikave ekzistuese.

Sipas të dhënave statistikore është e dukshme se shumica e rasteve i referohen diskriminimit të shumëfishtë (kumulativ dhe ndërseksional), kurse nga rastet numri më i madh i rasteve i




Gjatë këtij viti u dokumentuan gjithsej 31 raste të diskriminimit, të cilat reflektojnë probleme sistemore me romët, gratë, në veçanti gratë me funksione publike dhe gratë nga bashkësitë etnike pakicë, personat LGBTI, personat me aftësi të kufizuara dhe bashkësitë religjioze jo shumicë.

referohen diskriminimit bazura në seks dhe gjini, aftësi të kufizuar dhe përkatësi etnike. Sa i përket sferave të diskriminimit, më të përfaqësuara janë qasja në të mira dhe shërbime dhe pastaj vijnë edhe marrëdhëniet e punës, arsimi dhe shëndetësia, diçka që i përngjan gjendjes në vitin 2018. Shoqëritë civile edhe më tej janë më aktive sa i përket ngritjes së vetëdijes dhe informimit të qytetarëve për diskriminimin dhe mekanizmat mbrojtës.

Në muajin prill të vitit 2019, Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi, pas inicimit të procedurës nga Komiteti i Helsinkit e miratoi akt-opinionin e parë në të cilin konstatohet diskriminim mbi bazën e zbatimit të testimit të situatës, si metodë për argumentimin e diskriminimit.

Për të përmirësuar sistemin për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi duhet:

- Zgjedhje urgjente dhe transparente të anëtarëve cilësorë dhe profesionistë të Komisionit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, që do ta reflektonin përbërjen e shoqërisë si tërësi.
- Rritje të fushatave informuese shtetërore për ngritjen e vetëdijes për fenomenin e diskriminimit, format e paraqitjes dhe mekanizmat mbrojtës nga diskriminimi.
- Formim urgjent dhe transparent të shërbimit administrativ profesional të Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi.
- Përmirësim të sistemeve të institucioneve shtetërore dhe gjykatave për grumbullimin dhe regjistrimin e të dhënave në lidhje me rastet e diskriminimit.



GJUHA

E

URREJTJES

MONITORIMI I GJUHËS SË URREJTJES NË VITIN 2019

Në vitin 2019, u regjistruan gjithsej 605 raste të gjuhës së urrejtjes përmes portalit në internet www.govornaomraza.mk. Nga analiza e kryer e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, u identifikuan katër kategori si më të ndjeshme në kontekstin shoqëror, edhe atë gjuhë urrejtjeje për shkak të përkatësisë etnike (30%), për shkak të orientimit seksual (30%), përkatësisë politike (ose 18%) të të gjithë rasteve.

Aspekti negativ bazohet në ecurinë e identifikuar të trafikut në rritje të gjuhës së urrejtjes në mediat sociale, si reagim i zhvillimeve shoqërore që u karakterizuan si polarizuese në vitin 2019: miratimi i ndryshimeve kushtetuese në Kuvend, shpallja e Ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi.

Numri më i madh i rasteve u regjistruan në maj dhe qershor, pas njoftimit për organizimin e Paradës së krenarisë dhe mbajtjes së saj në qershor të vitit 2019. Deri në fund të vitit mbizotëruan temat politike, në veçanti rasti Zhvatja.

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut mbi bazën e urgjencës së rasteve ka parashtruar 19 kundërshtime në Ministrinë për Punë të Brendshme. Megjithatë, edhe përkundër rritjes së vetëdijes publike për identifikimin dhe denoncimin e gjuhës së urrejtjes, mungon qasja sistemore nga ana e institucioneve që do të shpie në përforcimin e mekanizmave kombëtarë të parandalimit në luftën mkundër gjuhës së urrejtjes.



Ky fenomen ishte gjithashtu aktual edhe në nivel të Bashkimit Evropian, në veçanti përmes miratimit të Kodit të mirësjelljes së kompanive të mëdha të teknologjisë së informacionit, që ka për qëllim sanksionimin e gjuhës së urrejtjes në mediat sociale². Rekomandimet e përfshira në Kod, në masë të madhe korrespondojnë me konstatimet e Komitetit sidomos në nevojën e partneritetit midis institucioneve kombëtare dhe organizatave të shoqërisë civile për krijimin e rrjetit të monitorimit. Gjithashtu, konstatohet edhe nevoja e fushatave publike për edukimin e qytetarëve si dhe trajnimet e specializuara të të gjithë nëpunësve që punojnë në këto çështje.

² https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/hatespeech_infographic3_web.pdf

PASQYRË TREMUJORËSHE E SITUATËS ME GJUHËN E URREJTJES

janar – mars 2019

Në tremujorin e parë të vitit 2019 janë regjistruar gjithsej 138 denoncime për gjuhë të urrejtjes në mediat sociale. Nga to, numri më i madh (40%) i referohen gjuhës së urrejtjes për shkak të përkatësisë etnike, kurse nga 17% i referohen tre kategorive: 1) gjini dhe seks, 2) orientim seksual dhe identitet gjinor dhe 3) përkatësi politike.



Për këtë periudhë, kjo rritje korrespondon me dy zhvillime të rëndësishme politike në vendin tonë – miratimi i Amandamenteve kushtetuese në pajtim me Marrëveshjen e Prespës të datës 11 nëntor 2019 dhe shpallja e Ligjit për përdorimin e gjuhëve kah mesi i muajit. Në atë periudhë


kohore u regjistrua një rritje e rasteve të bazuara në përkatësinë etnike dhe politike. Krahasuar me vitin 2018, vërehet rritje e numrit të denoncimeve të bazuara në orientimin seksual, gjininë dhe seksin, që sipas strukturës së rasteve të denoncuar përbënin 1/3 e numrit të përgjithshëm të denoncimeve.

Bazuar në monitorimin e kryer të gjuhës së urrejtjes për muajin janar, mund të konstatohet një reagim i dobët i institucioneve përgjegjëse për sanksionimin e këtij fenomeni. Mbi bazën e denoncimeve të gjuhës së urrejtjes, shumica e denoncimeve u vëren në periudhën midis datave 12 dhe 17 shkurt. Rritja drastike e numrit të rasteve të gjuhës së urrejtjes në mediat sociale për shkak të përkatësisë etnike ka të bëjë me aksidentin me autobus që ndodhi në autostradën Shkup-Gostivar (Laskarcë) dhe vendimin për shpërndarjen e parave nga programi vjetor i Ministrisë së Kulturës për vitin 2019. Gjithashtu në muajin shkurt, pati një rritje të gjuhës së urrejtjes në mediat sociale për shkak të gjinisë dhe seksit. Në krahasim me tremujorin e fundit të vitit 2018, mund të konkludohet se ndërgjegjësimi i qytetarëve për identifikimin e gjuhës së urrejtjes ka një prirje pozitive dhe qytetarët gjithnjë e më shumë janë të inkurajuar për të denoncuar këtë fenomen. Megjithëse ka një reagim të shtuar të autoriteteve kompetente sa i përket veprimit ndaj rasteve të gjuhës së urrejtjes, prapëseprapë vlerësohet se ekziston nevoja për një qasje më proaktive dhe sanksionimin në kohë të këtij fenomeni dhe informimi i qytetarëve.

Sipas denoncimeve të gjuhës së urrejtjes, numri më i madh i denoncimeve janë vërejtur në periudhën pas miratimit të Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi. Vërehet rritje e gjuhës së urrejtjes në mediat sociale për shkak të gjinisë dhe seksit në kontekst të miratimit të ligjit të ri dhe diskursit negativ që mbizotëronte në rrjetet sociale. Edhe përkundër numrit të lartë të denoncimeve mungon qasja sistemore nga ana e institucioneve përgjegjëse për sanksionimin dhe dënimin e këtij fenomeni.

prill – qershor 2019



Në tremujorin e dytë të vitit 2019, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka regjistruar 211 denoncime të gjuhës së urrejtjes. Krahasuar me tremujorin e parë, vërehet një rritje drastike e gjuhës së urrejtjes bazuar në orientim seksual dhe identitet gjinor (34%) dhe përkatësi etnike (28%).



Gjuha diskriminuese dhe gjuha e urrejtjes bazuar në përkthësi etnike dhe politike ishte regjistruar në mediat sociale, Fejsbuk dhe Tvider nga ana e opinionit të gjerë. Në periudhën prej datës 1 prill 2019 përfundimisht me ditën e rrethit të dytë të zgjedhjeve për kryetar shteti, në portalin e internetit www.govornaomraza.mk ishin regjistruar gjithsej 69 raste të gjuhës së urrejtjes. Numri më i madh i rasteve të verifikuara u referoheshin gjuhës së urrejtjes për shkak të përkatësisë etnike (31% prej numrit të denoncimeve), gjuhës së urrejtjes për shkak të përkatësisë politike dhe për shkak të gjinisë dhe seksit (me nga 21% të numrit të përgjithshëm të denoncimeve) dhe 14 denoncime të gjuhës së urrejtjes për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor (16%). Nga denoncimet e pranuar për gjuhë të urrejtjes, numri më i madh janë regjistruar gjatë kohës së fushatës politike. Pas përfundimit të zgjedhjeve presidenciale vërehet një ulje drastike e numrit të denoncimeve për gjuhë të urrejtjes. Gjuha e urrejtjes e cila u rrit në mënyrë drastike në ditën e organizimit të pritjes solemne të KH Vardar nga ana e grupit të tifozëve Komiti kur edhe u regjistrua gjuhë diskriminuese bazuar në përkatësi etnike. Për këtë

fenomen, Komiteti i Helsinkit adresoi edhe një reagim në institucionet përgjegjëse. Rritja më e madhe është vërejtur në periudhën e organizimit të Paradës së krenarisë, respektivisht 50% të numrit të përgjithshëm të denoncimeve. Komiteti i Helsinkit rregullisht i ka dokumentuar denoncimet dhe të njëjtat ia ka dorëzuar Ministrisë së Punëve të Brendshme.

korrik – nëntor 2019




Ajo që ishte regjistruar nga ana e përfaqësuesve të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ishte rritja e prirjes së gjuhës së urrejtjes në mediat sociale në lidhje me festimin e Ditës së Republikës – Ilinden, sidomos në kontekst të festimit të përbashkët me Republikën e Bullgarisë. Gjithashtu ishin regjistruar edhe thirrje për linçim publik të personaliteteve publike. Prirja e gjuhës së urrejtjes për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, gjegjësisht gjinisë dhe seksit, vazhdoi edhe në muajin gusht si rezultat i rastit “Zhvatja”. Gjuha e urrejtjes ishte fokusuar

ndaj të pandehurit Bojan Jovanovski (Boki 13) në rastin dhe indicien për përfshirjen e nëpunësve të lartë publikë në këtë skandal.


Krahasuar me tremujorin e fundit të vitit 2018, mund të konkludohet se ndërgjegjësimi i qytetarëve për identifikimin e gjuhës së urrejtjes ka një prirje pozitive dhe qytetarët gjithnjë e më shumë janë të inkurajuar për të denoncuar këtë fenomen. Megjithëse ka një reagim të shtuar të autoriteteve kompetente sa i përket veprimit ndaj rasteve të gjuhës së urrejtjes, prapëseprapë vlerësohet se ekziston nevoja për një qasje më proaktive dhe sanksionimin në kohë të këtij fenomeni dhe informimi i qytetarëve.

Aspekti negativ është prirja e konstatuar e rritjes së gjuhës së urrejtjes në mediat sociale si fenomen që paraqitet si rezultat i kontekstit politik në vend:

- ndryshimet kushtetuese të Marrëveshjes së Prespës me Greqinë dhe përkatësia e ashpërsuar politike gjatë zgjedhjeve presidenciale;
- marrëdhëniet ndëretnike që vazhdimisht janë aktuale në mediat sociale;
- reagimi i opinionit konservativ sa i përket progresit në sferën e të drejtave të komunitetit LGBTI, si rezultat i ndryshimeve ligjore.
- nga ana tjetër, si aspekt pozitiv mund të trajtohet ndërgjegjësimi në rritje i qytetarëve për të identifikuar dhe denoncuar gjuhën e urrejtjes përmes internetit.



2 Platforma e Komitetit të Helsinkit për denoncimin e gjuhës së urrejtjes




**VEPRA
NGA
URREJTJA**

RRITJE E KRIMEVE NGA URREJTJA, PËRKATËSIA ETNIKE DHE BINDJA POLITIKE JANË MOTIVET MË TË SHPESHTA

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut gjatë vitit 2019 ka regjistruar 159 raste të kryera nga urrejtja. Ky numër na bën me dije për rritjen e krimeve nga urrejtja, nëse merret parasysh rritja e konsiderueshme e incidenteve të regjistruara në vitin 2018 (123). Nga numri i përgjithshëm i incidenteve, 33 (20%) janë verifikuar, kurse 126 incidente (80%) kanë mbetur të pakonfirmuara. Të pakonfirmuara mbetën numri më i madh i rasteve, ku sipas treguesve të tjerë (vendndodhja, mënyra e kryerjes së veprës, përfshirja e nxënësve të shkollave të mesme etj.) ekziston dyshim i arsyeshëm se këto vepra janë kryer për shkak të përkatësisë etnike të viktimës. Edhe përkundër kërkesave të adresuara për të dhëna për të konfirmuar indiciet, Ministria e Punëve të Brendshme nuk është përgjigjur pozitivisht dhe si rezultat i kësaj ka munguar verifikimi i këtyre veprave të kryera nga urrejtja.

Përkatësia etnike dhe bindja politike janë motivet më të zakonshme për veprat e kryera në vitin 2019. Përkatësia etnike si motiv në veprat e kryera nga urrejtja paraqitet në 85% të rasteve të regjistruara., përkatësia politike me 9,4%, statusi i emigrantit ose refugjatit 1,2%, religjioni dhe bindja religjioze 1,2%, kombësia 1,2%, orientimi seksual 1,2% dhe raca 1%. Në vitin 2019 ishin regjistruar 2 raste të veprave të kryera nga urrejtja për shkak të orientimit seksual/identitetit gjinor të viktimës. Incidentet sporadike ndodhën në periudhën kur organizohej Parada e parë e krenarisë në Shkup. Në këtë periudhë, gjuha e urrejtjes dhe kërcënimet ndaj komunitetit LGBTI ishin të pranishme në mënyrë të konsiderueshme.

Motivimi i njëanshëm




 Përkatësia etnike	35	 Bindja politike	15
 Rasa	1	 Statusi emigrantit/refugjat	2
 Religjioni dhe besimi religjioz	2	 Orientimi seksual	2
 Kombësia	2		

Viktimat dhe autorët e veprave nga urrejtja edhe këtë vit zakonisht janë të rinj dhe pjesëtarë të bashkësive të ndryshme etnike (zakonisht maqedonas dhe shqiptarë), pjesëtar të klubeve të tifozëve ose mbështetës të njërës prej tri partive më të mëdha politike në vendin tonë. Është me rëndësi të theksohet se në vitin 2019, Komiteti i Helsinkit për herë të parë ka regjistruar numër më të madh të personave të mitur – viktimat të veprave nga urrejtja në krahasim me të mitur – autorët të veprave nga urrejtja. Në fakt, nga 81 incidente të regjistruara ku ishin përfshirë persona të mitur, ishin regjistruar 104 viktimat të mitur, krahasuar me më shumë se 93 të mitur, autorë të mitur të veprave nga urrejtja.

Numri më i madh i incidenteve (115) i përmbushin elementet e veprës penale „Dhunë”, edhe pse shumë shpesh autoritetet e ndjekjes këto incidente i klasifikojnë si kundërvajtje, duke ndihmuar praktikën e ndjekjes joefikase të krimeve nga urrejtja.

Dëmtime pronash janë regjistruar te 16 incidente, zakonisht te incidentet e kryera për shkak të përkatësisë politike ose religjionit dhe besimit religjioz (dëmtim automjetesh, shtëpish, gjësendesh të tjera, objekte fetare ose shtetërore, si dhe shtabe të partive politike).

Lloji I veprave penale



● Dhunë	112	● Dëmtimi i pronës	16
● Lëndime trupore	16	● Rrezikim i sigurisë	2
● Nxitja e urrejtjes etnike, racore dhe fetare dhe pëçarjes dhe mosdurimit	12	● Grabitje	2

Amandamentet e Kodit Penal në lidhje me veprat nga urrejtja ishin votuar në dhjetor të vitit 2018 dhe kishin hyrë në fuqi më 8 janar 2019. Këto ndryshime paraqesin risi të rëndësishme në

legjislacionin tonë dhe me hyrjen e tyre në fuqi në të ardhmen pritet një rritje e ndjekjes penale të veprave nga urrejtja.

INSTITUCIONET I SHPËRFILLIN VEPRAT NGA URREJTJA

Në vitin 2019, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka ofruar ndihmë juridike për viktimat e veprave nga urrejtja, kurse dy nga ato raste po i paraqesim si ilustrim për veprimin e institucioneve ndaj këtyre veprave:




Një prej rasteve që u gjet para Komitetit kishte lidhje me një sulm fizik ndaj një personi për shkak të **orientimit të tij seksual**. Ekipi juridik i Komitetit të Helsinkit e kishte shoqëruar personin në fjalë deri në stacionin policor për të denoncuar rastin, ku përkundër insistimit që ky rast të regjistrohet si vepër nga urrejtja, policia e kishte kualifikuar si vepër kundërvajtjeje.

Në qershor të vitit 2019, Komiteti i Helsinkit parashtrori padi penale në Prokurorinë themelore publike. Rasti i referohej një sulmi fizik ndaj një djaloshi të ri në qendër të qytetit për shkak të **ngjyrës së lëkurës dhe racës**. Rastin e kishte denocuar e ëma e viktimës, pasi që paraprakisht në stacionin policor rasti ishte regjistruar si prishje e rendit dhe qetësisë publike. Për shkak të faktit se policia nuk e identifikoi këtë rast si vepër nga urrejtja, në qershor të vitit 2019, Komiteti i Helsinkit së bashku me të ëmën e viktimës parashtruan padi penale në Prokurorinë themelore publike në Shkup. Përkundër faktit që kaluan më shumë se gjashtë muaj nga parashtrimi i padisë, lënda ende gjendet në prokurori.

Veprimi i autoriteteve të ndjekjes, policia dhe prokuroria publike, në këto raste dështoi sa i përket hetimit efektiv, të shpejtë dhe në kohë dhe në ndjekjen e veprave nga urrejtja duke i anashkaluar plotësisht motivet e njëanshme në rastet individuale.

Çfarë duhet të bëjmë për trajtimin e veprave nga urrejtja dhe si t'i parandalojmë ato:

- Të sigurohet ndjekje efektive, e shpejtë dhe në kohë dhe të ndiqen veprat nga urrejtja duke garantuar se motivet e njëanshme do të merren në konsideratë gjatë procedurës penale;
- Të merren masa përkatëse për të nxitur denoncimin e veprave nga urrejtja nga ana e viktimave, përfshi masat e ndërtimit të besimit te policia dhe institucionet e tjera shtetërore;
- Të mblidhen dhe të publikohen të dhëna gjithëpërfshirëse dhe krahasuese për veprat nga urrejtja, mundësisht sa më shumë përfshi edhe numrin e incidenteve të tilla të denoncuar nga qytetarët dhe të regjistruara nga ana e autoriteteve të zbatimit të ligjit; numri i aktgjykimeve; motivet e njëanshme pas atyre veprave penale; dhe dënimet e shqiptuara për autorët;
- Të sigurohet se viktimat e veprave nga urrejtja të kenë përkrahje dhe të jenë të mbrojtura;
- Të avancohet trajnimi i praktikantëve të rëndësishëm që vijnë në kontakt me viktimat e veprave nga urrejtja, duke u mundësuar këtyre viktimave ndihmë efikase; dhe
- Të përforcohen masat parandaluese, ndër të tjerat edhe përmes reflektimit të edukimit për të drejtat e njeriut, planet arsimore nga historia dhe trajnimet relevante, marrja e masave për edukimin e qytetarëve, sidomos të fëmijëve dhe të rinjve për vlerat e diversitetit kulturor dhe inkluzionit, me qëllim që të gjithë sektorët shoqërorë të kenë rol të caktuar në luftën me këtë jotolerancë.




**INSTITUCIONE
TË
MBYLLURA**

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në vitin 2019 vazhdoi të monitorojë gjendjen dhe kushtet nëpër burgje. Me zëvendësimin e udhëheqësisë në Drejtorinë për zbatimin e sanksioneve ishte mundësuar qasje e pandërprerë në institucionet ndëshkuese-korrektuese, krahasuar me praktikën paraprake të shpërfilljes së plotë të kërkesave të parashtruara për vizita në këto institucione. Në periudhën shkurt - shtator 2019, përfaqësuesit e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut realizuan vizita njëditëshe në institucionet ndëshkuese-korrektuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut, di dhe tri vizita shtesë në SHNK Shtip, ENK Kumanovë dhe ENK Ohër. Si rezultat i bashkëpunimit me Drejtorinë për zbatimin e sanksioneve, Komiteti i Helsinkit përgatiti një raport të veçantë për gjendjen dhe kushtet në institucionet ndëshkuese-korrektuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Gjatë vitit 2019 është vërejtur një përmirësim në uljen e mbipopullimit të burgjeve, si rezultat i miratimit të Ligjit për amnisti, por edhe pavijonit të ri të ndërtuar sipas standardeve për rreth 600 të burgosur në burgun më të madh në vend, kurse së shpejti do të vihet në përdorim edhe burgu i të miturve në Tetovë. Megjithatë, mbetën shuma sfida të tjera lidhur me institucionet ndëshkuese-korrektuese për të cilat duhet një qasje sistemore. Buxheti për institucionet ndëshkuese-korrektuese krahasuar me vitin paraprak është ulur për 60% që reflektohet edhe në furnizimin me ushqim dhe në kushtet higjienike. Vetë personat që punojnë në këto institucione ballafaqohen me sfida, paga të ulta dhe presione ndaj gjendjes së tyre psikike. Edhe më tej po zvarriten problemet serioze sa i përket qasjes në arsimim, shëndetësi, risocializim dhe kushteve materiale.

Raporti i veçantë përmban një përmbledhje nga monitorimi i realizuar në terren dhe i adreson progresin dhe sfidat e dokumentuara gjatë vizitave dhe ofron rekomandime për institucionet përgjegjëse në drejtim të përmirësimit të gjendjeve dhe kushteve në institucionet ndëshkuese-korrektuese.

ИЗВЕШТАЈ



ЗА СОСТОЈБАТА И УСЛОВИТЕ
ВО КАЗНЕНО-ПОПРАВНИТЕ УСТАНОВИ
ВО РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА



Rekomandime për pëpërmirësimin e gjendjeve dhe kushteve në institucionet ndëshkuese-korrektuese

- Përbushje urgjente të detyrimit ligjor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës sa i përket qasjes së personave të gjykuar në arsim, sidomos për personat e mitur të privuar nga liria;
- Marrja e koordinuar dhe urgjente e detyrimit të Ministrisë së Shëndetësisë për ofrimin e mbrojtjes shëndetësore për të gjithë personat e gjykuar;
- Zhvillimi dhe zbatimi i programeve përkatëse për risocializimin e personave të gjykuar, kundrejt praktikës së deritanishme të udhëheqjes së dosjeve për progresin e personit të gjykuar;
- Vazhdimi i përpjekjeve për rindërtimin e objekteve të vjetra të institucioneve ndëshkuese-korrektuese për të mundësuar kushte njerëzore nëpër burgje;
- Përpjekje serioze për riaktivizimin e njësive ekonomike, punëtorive të zanatit në institucionet ndëshkuese-korrektuese për të mundësuar angazhim pune për personat e gjykuar dhe zhvillimin e aftësive të punës që janë në dobi të risocializimit të tyre;
- Angazhimi i kuadrit përkatës në institucionet ndëshkuese-korrektuese, sidomos sa i përket risocializimit dhe punës individuale me të burgosurit siç janë edukatorët, punëtorët socialë dhe psikologët.
- Zhvillimi i moduleve të ndihmës post-penale të personave të gjykuar të cilët janë kah fundi i vuajtjes së dënimit me burg, përmes përfshirjes së institucioneve dhe autoriteteve relevante të vetëqeverisjes lokale, Agjencisë për Punësim dhe organizatave joqeveritare;
- Ambientet ku janë të vendosur të miturit e privuar nga liria duhet të jenë të pajisur në atë mënyrë që të mundësojnë kushte pozitive dhe të personalizuara, duke respektuar dinjitetin dhe privatësinë e tyre;
- Trajnim dhe senzibilizim i policisë së burgjeve për punë me persona të mitur;
- Hapje urgjente e objektit të ri për Shtëpinë edukuese-korrektuese Tetovë në Vollkovi dhe transferim të fëmijëve të vendosur në ENK Ohër;
- Hetim serioz, në kohë dhe i duhur i çdo dyshimi për trajtim çnjerëzor, veprim çnjerëzor dhe torturë;



Gjatë vitit 2019, Komiteti i Helsinkit realizoi fushatën „Të drejtat tuaja të njeriut nuk zhduken pas grilave” dedikuar për informimin mbi të drejtat e personave që vuajnë dënimin në institucionet ndëshkuese-korrektuese në vend dhe mundësinë që të drejtohen për ndihmë juridike në Komitetin e Helsinkit.

KATEGORITË E RREZIKUARA

PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Vlerësimi i funksionalitetit kundrejt pengesës (kufizimit)

Duke filluar nga muaji prill i këtij viti, në vendin tonë ishte formuar një Trupë e re profesionale për zbatimin e modelit të ri për vlerësim funksional të fëmijëve me aftësi të kufizuara sipas Klasifikimit ndërkombëtar të funksionimit, kufizimit dhe shëndetit (KNF). Kundrejt modelit të deritanishëm të kategorizimit të aftësive të kufizuara të fëmijët, në fokusin e të cilit ishte shkalla e pengesës (kufizimit), modeli i ri sipas KNF-së ka për qëllim zhvillimin e potencialit ekzistues të fëmijës përmes analizës së shkallës së funksionalitetit, por edhe barrierave ekzistuese në rrethinë. Përveç mundësive për përfshirje më të përshtatshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara duke zbuluar dhe zhvilluar aftësitë e tyre individuale, modeli i ri i vlerësimit kontribuon gjithashtu në uljen e vetëstigmatizimit nga familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara, që ishte një nga arsytet për të shmangur kategorizimin sipas modelit tashmë të vjetëruar.

Qendra e re për vlerësim funksional dhe mbështetje të fëmijëve dhe të rinjve, brenda së cilës funksionojnë një organ kombëtar dhe dy organe profesionale për vlerësim, është vendosur në ish Shtëpinë e fëmijëve

pa prindër dhe pa kujdes prindëror „11 Tetori“ në Shkup, e cila është pjesë e planit për shndërrimin e ambienteve të shtëpisë me procesin e deinstitutionalizimit. Vlerësimi, varësisht nga nevojat e fëmijës, përveç në Qendër zbatohet edhe në Shtëpi, si dhe në institucionet arsimore ku është përfshirë fëmija. Në procesin e vlerësimit janë përfshirë prindërit, kujdestarët ose personat e tjerë që kujdesen për fëmijën.

Duke marrë parasysh se Trupa profesionale për vlerësim sipas KNF-së funksionon si pjesë e një projekt-aktiviteti i cili përfundon deri në fund të vitit, duhet që të gjendet një zgjidhje përkatëse për themelimin e saj si organ i përhershëm i një rëndësie të veçantë për përgatitjen e rekomandimeve për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në procesin arsimor.

Arsimi inkluziv

Në muajin gusht të këtij viti u miratua Ligji i ri për arsim fillor³, i cili filloi të zbatohet në

³ Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 161/2019

2019/2020, sipas të cilit arsimi fillor është organizuar në mënyrë institucionale, kadrovike dhe përmbajtësore që të mundësojë përfshirje të të gjithë fëmijëve në arsimin e rregullt fillor. Për të siguruar mbështetje përkatëse në tërë procesin arsimor të fëmijëve me aftësi të kufizuara, Ligji parashikon lloje të ndryshme mbështetjesh në disa nivele. Është parashikuar mbështetje përmes angazhimit të asistentëve arsimorë dhe personalë, formimit të ekipeve shkollare inkluzive, sigurimit të teknologjive sistuese, përgatitjes së planeve individuale arsimore, si dhe detyrimi për përshtatje të arsyeshme dhe ofrim të qasjes në infrastrukturën dhe shërbimet arsimore. Ligji i ri ofron përkufizime të qarta për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, duke i përfshirë tri kategori nxënësish: nxënës me aftësi të kufizuara, nxënës me çrregullime në sjellje ose me problem emocionale ose me vështirësi specifike në të mësuarit dhe nxënës nga mjedise të papërshtatshme socio-ekonomike, kulturore dhe gjuhësore.

Përkundër faktit se përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin e rregullt për herë të rregullohet me ligj dhe Ligji parashikon një sërë ndryshimesh për të përshtatur tërë procesin arsimor, që nga fillimi i vitit shkollor janë vërejtur mangësi të shumta në zbatimin e tij. Një ndër problemet më të mëdha që e ka regjistruar Komiteti i Helsinkit doli nga numri jopërkatës i

asistentëve arsimorë dhe personalë që ishin në dispozicion të shkollave, të cilët në masë të madhe nuk korrespondojnë me nevojat e nxënësve. Sipas konstatimeve të hulumtimit që ka realizuar Avokati i Popullit për tre muajt e parë nga zbatimi i Ligjit për shkollat në Shkup, janë përmbushur vetëm 26% të nevojave për asistentë arsimorë dhe 73% të nevojave për asistentë personalë.⁴ Sipas të njëjtit hulumtim, faktorët më të rëndësishëm që kontribuojnë për rëndimin e përfshirjes është mungesa e përgatitjes së shkollave për zbatimin e dispozitave ligjore, respektivisht kuadri arsimor me përgatitje të pamjaftueshme, mjedisi i papërshtatshëm për mësim dhe mungesë qasje në infrastrukturën e shkollave.

Një vështirësi shtesë në zbatimin e Ligjit është mosmiratimi i akteve të parashikuara nënligjore. Koncepti për arsim inkluziv, që është parashikuar të miratohet më së voni në një afat prej 6 muajsh nga miratimi i Ligjit, nuk u miratua gjatë vitit vijues, madje as aktet nënligjore që kishin një afat prej 1 viti nga miratimi i Ligjit.

Institucionet përgjegjëse duhet sa më parë t'i miratojnë aktet nënligjore për të siguruar zbatim përkatës të Ligjit dhe përfshirje në procesin arsimor nga çdo aspekt. Në këtë mënyrë, duhet pasur parasysh edhe rrezikun e krijimit të një prirje të re të ndarjes në vetë shkollat duke i lënë plotësisht fëmijët me aftësi të kufizuara vetëm në duart e

⁴<http://ombudsman.mk/upload/Posebni%20izvestai/2019/Poseben%20izvestaj->

<Deca%20so%20posebni%20potrebi%20vo%20skopski%20region-2019.pdf>

asistentëve arsimorë dhe/ose edukatorëve specialë dhe rehabilituesve.

Mbrojtja sociale

Ligji i ri për mbrojtje sociale⁵ ishte miratuar në muajin maj të këtij viti. Me tekstin e ri të Ligjit një pjesë e të drejtave dhe shërbimeve të përfhira në Ligjin e mëparshëm u ndryshuan dhe/ose riformuluan, kurse njëherit ishin parashikuar edhe një sërë të drejtash dhe shërbimesh plotësisht të reja për mbrojtje sociale, si shërbime në shtëpi, në bashkësi dhe mbrojtje jashtë familjes. Zhvillimi i këtij lloji shërbimesh është në përputhje me objektivat e procesit të deinstitutionalizimit, që do duhej të kontribuojë në lehtësimin dhe mbështetjen e procesit të transferimit të përdoruesve nga institucionet për mbrojtje sociale nga njëra anë, por edhe të parandalojë në të ardhmen deinstitutionalizimin dhe riinstitutionalizimin, përmes mbështetjes në shtëpi dhe në bashkësi, nga ana tjetër. Sa i përket konceptit të deinstitutionalizimit, Ligji parashikon edhe transformimin e institucioneve ekzistuese për mbrojtje sociale në një shërbim të ri për shërbime sociale.

Nga të dhënat e mbledhura nga kërkuesit e ndihmës juridike, si dhe nga bisedat me përdoruesit e të drejtave për mbrojtje

sociale, rezultoi që përdoruesit nuk janë të informuar sa duhet për ndryshimet që ishin përfshirë në Ligjin e ri dhe një pjesë e tyre konsiderojnë se u janë shkurtuar disa të drejta që i kishin pasur në Ligjin paraprak. Komiteti i Helsinkit konsideron se informimi i pamjaftueshëm i përdoruesve rezulton nga mosnjohja e mjaftueshme e ndryshimeve ligjore nga ana e ofruesve të shërbimeve – përgjegjës për zbatimin e Ligjit dhe njëherit ekziston nevoja e unifikimit dhe zbatimit të drejtë të dispozitave ligjore.

Од прибраните податоци од барателите на правна помош, како и од разговори со корисници на права од социјална заштита, произлезе дека корисниците се недоволно информирани за промените што беа воведени со новиот Закон и дел од нив сметаат дека им се ускратени некои права што ги имале со претходниот Закон. Хелсиншкиот комитет смета дека несоодветната информираност на корисниците произлегува од недоволното познавање на законските промени од страна на давателите на услуги надлежни за спроведување на Законот и притоа потребно е унифицирање и правилна примена на законските одредби.

Deinstitutionalizimi

Edhe në vitin 2019, Komiteti i Helsinkit vazhdoi aktivisht të monitorojë procesin e

⁵ Gazeta Zyrtare e RMV-ës, nr. 104/2019

deinstitucionalizimit dhe zbatimit të Strategjisë kombëtare për deinstitucionalizim (2018-2027) „Timjanik“. Procesi i deinstitucionalizimit, fokusi i të cilit në periudhën e kaluar ishte kah fëmijët e kujdesur në institucionet për mbrojtje sociale, gjat vitit 2019 vazhdoi të zbatohet edhe për personat në moshë madhore. Ritmi i përshpejtuar i procesit në 2018 vazhdoi edhe në vitin 2019, me hapjen e shtëpive të reja të grupeve të vogla, transformimin e institucioneve ekzistuese, si dhe zhvillimin e shërbimeve brenda komunitetit lokal. Aktivitetet për zhvillimin e shërbimeve lokale, ndër të tjerat, përfshinë edhe fillimin e procesit të transformimit të qendrave ditore për fëmijë dhe persona me aftësi të kufizuara, siç janë kategorizimi i përdoruesve varësisht nga moshja, riorganizimi i punës, përgatitja e planeve të reja individuale për zhvillimin e përdoruesve, sigurimi i kuadrit dhe trajnimi përkatës profesional, si dhe përmirësimi i infrastrukturës së qendrave.

Me transferimin e fëmijëve nga Shtëpia për foshnja dhe fëmijë të vegjël „Shtëpia e Nënës“ në Manastir ishin kujdesur edhe fëmijët e fundit nën moshën trivjeçare, kurse me transferimin e fëmijëve të vendosur në Entin për përkujdesje, edukim dhe arsimim të fëmijëve dhe të rinjve „Ranka Millanoviq“, me përfundimin e vitit 2019, të gjithë fëmijët nën moshën 18 vjeç e lëshuan të jetuarit institucional dhe u vendosën në forma alternative të përkujdesjes jointucionale, si në familje për përkujdesje dhe shtëpi të grupeve të vogla. Shtëpitë për grupe të vogla ofrojnë kujdes dhe/ose mbikëqyrje 24-

orëshe si dhe mbështetje profesionale për zhvillimin e duhur të fëmijëve dhe integrimin e sërishëm të tyre në mjedis. Me procesin e transformimit të infrastrukturës të tashmë institucioneve të mbyllura, një pjesë e shtëpisë në Manastir është në proces e sipër për ta shndërruar në kopsht fëmijësh, kurse pjesa tjetër në Qendër rajonale për mbështetjen e familjeve kujdestare.

Me fillimin e zhvendosjes së përdoruesve nga Enti special në Demir Kapi në vitin 2018 brenda tre shtëpive të grupeve të vogla në Negotinë, f. Timjanik dhe në Shkup, në vitin 2019 procesi i deinstitucionalizimit vazhdoi me hapjen e dy shtëpive të reja të grupeve të vogla në f. Koreshnicë më 31 korrik dhe një shtëpie tjetër në Shkup më 8 tetor. Hapja e shtëpisë së dytë për grupe të vogla në Shkup, njëherit paraqet edhe shembullin e parë të bashkëpunimit midis institucionit publik për mbrojtje sociale (MS Demir Kapi), vetëqeverisjes lokale (Qyteti i Shkupit) dhe shoqatës civile (Lidhja e rehabilituesve dhe edukatorëve specialë) për ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes sociale në bashkësinë lokale. Këtë vit procesi i deinstitucionalizimit filloi edhe në Entin për mbrojtje dhe rehabilitim „Banja BANSKO“ me zhvendosjen e 7 përdoruesve me aftësi të kufizuara fizike në njësi të reja banimi për jetë të pavarur dhe jetë me mbështetje.

Parashikimet aktuale të Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale sa i përket procesit të deinstitucionalizimit janë se deri në fund të vitit 2023, me mbështetjen e Delegacionit të BE-së dhe agjencive të KB-ës në vendin tonë,

nuk do të ketë më persona të kujdesur në institucionet për mbrojtje sociale.

ROMËT

Edhe më tej po vazhdon diskriminimi sistemor ndaj romëve pothuajse në të gjitha sferat shoqërore. Romët edhe më tej ballafaqohen me vështirësi të vazhdueshme në ushtrimin e të drejtave pothuajse në të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore. Nuk ka ndryshim dhe përmirësim as në zbatimin e aktiviteteve nga Strategjia e vlefshme për romët, shteti edhe më tej nuk arrin të sigurojë zbatim të plotë dhe efikas të Strategjisë, e cila gjendet në vitin e fundit të vlefshmërisë së saj.

Në vitin e kaluar ndaj romëve është regjistruar diskriminim sistemor, sidomos në ndalimin e qasjes së romëve në pishinat e notit. Vazhdon ndarja e fëmijëve romë në arsim, diskriminimi i shpeshtë i qasjes në të mira dhe shërbime, kurse edhe më tej ekziston edhe diskriminimi i qasjes në shërbimet shëndetësore. Shteti dështoi të merr masa aktive për parandalimin e

diskriminimit mbi bazën e përkatësisë etnike, ngjyrës së lëkurës dhe grupeve të marginalizuara.

Në muajin nëntor të vitit 2019, përfaqësues të Komitetit të Helsinkit ishin pjesëmarrës në sesionin e 12-të të forumit për të drejtat e pakicave të Kombeve të Bashkuara, e cila u mbajt në Gjenevë, tema e së cilës ishte arsimiti, gjuha dhe të drejtat e njeriut të pakicave. Komiteti i Helsinkit së bashku me katër organizata të Rrjetit për mbrojtjen e të drejtave të romëve dorëzoi parashtresë të Raportuesit special për çështjet e pakicave ku e informoi për tre problemet kryesore rreth përdorimit të gjuhës rome në rasim edhe atë: problemi me promocionin dhe informimin e pamjaftueshëm të nxënësve dhe prindërve mbi mundësinë për të zgjedhur gjuhën dhe kulturën rome si lëndë zgjedhore në arsimin fillor, mungesa e librave shkollorë nga lënda e gjuhës dhe kulturës rome për klasat 6 – 9 dhe mungesa e katedrave dhe profesorëve të gjuhës rome. Në këtë forum, përfaqësuesi i Komitetit të Helsinkit kishte mundësinë që të takohet me raportuesin special për çështjet e pakicave, Fernando de Varen të cilin personalisht e njoftoi për problemet e konstatuara.

TË DREJTAT E PUNËTORËVE

EDHE PËRKUNDËR LËVIZJEVE POZITIVE, TË DREJTAT E PUNËTORËVE PO SHKELEN PËR ÇDO DITË

Gjatë vitit të kaluar, shumë lehtë mund të vëreheshin tonet triumfaliste që përfaqësuesit qeveritarë njoftnin për uljen e papunësisë, për rritjen e pagave dhe për suksesin e masave të Qeverisë. Për një vend si i yni, i cili që nga pavarësia e tij deri më sot po përballet me një shkallë të lartë papunësie, kjo shifër është domosdoshmërisht një nga faktorët kryesorë shoqërorë që diktojnë marrëdhëniet, kulturën dhe funksionimin e institucioneve. Pikërisht për këtë arsye, është me rëndësi të pranohen zhvillimet pozitive në vitin e kaluar, por është më e rëndësishme që të analizohen seriozisht edhe shkeljet e hidhura të të drejtave të punëtorëve, që po ndodhin pothuajse çdo ditë.

Numri dyfish më i madh i rasteve dhe përfshirja konsiderueshëm më e madhe e punëtorëve në vitin 2019 është rezultat i veprimit aktiv të Komitetit drejt ngritjes së ndërgjegjes së punëtorëve dhe informimit për ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. Nga të dhënat e grumbulluara të punëtorëve që kanë kërkuar ndihmë në Komitetin e Helsinkit doli se një ndër problemet kryesore është mosnjohja e të drejtave të punëtorëve.

Në vitin 2019, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka regjistruar 166 raste shkeljesh të të drejtave të punëtorëve, që përfshinë të paktën 5401 punëtorë në vendin tonë.

Për krahasim, në vitin 2018 Komiteti kishte dokumentuar 70 raste duke përfshirë 300 punëtorë.

Që të përmirësohet informimi i punëtorëve për të drejtat e tyre të garantuara me ligj, gjatë periudhës janar - prill, Komiteti publikoi **karta informuese** me të cilën u informuan mbi 140 000 njerëz përmes Facebook dhe faqes sonë të internetit.

Për më tepër, gjatë muajve korrik dhe gusht, Komiteti i Helsinkit përgatiti Doracak për punonjës dhe punonjëse **„Puna ime – të drejtat e mia“** (përkthyer në gjuhën shqipe, rome dhe angleze), duke e afruar legjislacionin e shkapërderdhur të punës afër nevojave të punëtorëve, në mënyrë që të shpjegojë në tërësi elementet më kryesore për mbrojtjen e të drejtave të tyre.



4

SHKELJET DHE ARSYET MË TË ZAKONSHME PËR TRAJTIM NË VITIN 2019

Ndihma juridike në rastet e dokumentuara përbëhej nga këshillimi juridik, njoftimi i punëtorëve për të drejtat e tyre të punës, ngritja e procedurave administrative, udhëzimet për fillimin e proceseve gjyqësore nga sfera e punës dhe monitorimi i proceseve gjyqësore. Gjatë vitit, Komiteti i Helsinkit ka regjistruar numrin më të madh të shkeljeve të të drejtave të punëtorëve në lidhje me:

- Të drejtën e regresit për pushim vjetor;
- Shkeljet në vendin e punës;
- Ngritjen e procedurës në Inspektoratin Shtetëror të Punës për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe/ose udhëheqjen e procedurës gjyqësore për mosmarrëveshje nga sfera e marrëdhënieve të punës;
- Arsyetimet e pabazuara për pushim nga puna;
- Nënshkrimin e deklaratave boshe që më vonë punëdhënësi do t'i përdorte për të dëshmuar ndërprerjen me marrëveshje të marrëdhënies së punës;
- Diskriminimin në vendin e punës;
- Procedurën për mbrojtje nga ngacmimi në vendin e punës;
- Pagat dhe kontributet e papaguara nga ana e punëdhënësve;
- Regjistrimin dhe pagimin e punës jashtë orarit;
- Ushtrimin e të drejtave të punëdhënësi dhe largimi i veprimeve që i shkelin të drejtat e punëtorëve;
- Dispozitat që e rregullojnë punën me orar të shkurtuar të punës; dhe
- Mundësinë për të aplikuar në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi që të konsumohen të gjitha ilaçet juridike të vendit.

Shkeljet më të zakonshme të regjistruara nga Komiteti i Helsinkit kanë të bëjnë me të drejtën e regresit për pushim vjetor dhe shkeljet në vendin e punës, të cilat janë procesuar jo si duhet nga ana e Inspektoratit Shtetëror të Punës.

Pagë e barabartë për punë të barabartë midis burrave dhe grave

Tregu i punës në vendin tonë nuk ka shënuar ndryshime të rëndësishme sa i përket dallimit gjinor në vitin e kaluar. Ndërmjet burrave dhe grave edhe më tej mbizotërojnë dallime në aspektin e pagave dhe kompensimeve, dhe megjithëse ato janë pak më të larta se proporcionet në Bashkimin Evropian, dallimet rriten kur krahasohen pagat për punë të barabartë dhe vlerë të barabartë për burrat dhe gratë. Kjo do të thotë se sferat kryesore ku është i theksuar diskriminimi gjinor janë qasja në punësim, pagesa e barabartë për punë të barabartë dhe puna me vlerë të barabartë dhe efektet e karakteristikave të „fshehura“ të burrave dhe grave. Kjo situatë më shumë i rëndon gratë dhe i bënë më të prekura se burrat nga mundësitë e pabarabarta të tregut. Ato janë më pak aktive në tregun e punës, më pak të punësuara, fitojnë më pak të ardhura dhe shpesh ballafaqohen me varfëri më të madhe se burrat.

Gratë me arsim më të ulët, gratë nga mjediset rurale dhe gratë që merren me bujqësi janë më të prekura në tregun maqedonas të punës. Për shembull, gratë kanë gjasë më të madhe të punojnë si punëtore të papaguara në shtëpi, madje 9,4% e grave në krahasim me 4% prej burrave – dhe me shumë gjasë janë edhe të vetëpunësuara. Përkundër kësaj, punëtorët e papaguar në shtëpi përbëjnë përafërsisht ¼ nga gratë e varfëra të punësuara. Dallimi i papërshtatshëm i pagave në Maqedoninë e Veriut është 17 përqind, që është i krahasueshëm me dallimin mesatar në BE (16,2 përqind në vitin 2016). Megjithatë, për dallim nga BE-ja, dallimi i përshtatshëm i pagave në Maqedoninë e Veriut (që i merr parasysh karakteristikat e të punësuarve) është më i lartë se ai i papërshtatshëm (i njomë), sepse gratë e punësuara kanë arsim më të mirë se të punësuarit burra. Studime në dispozicion vlerësojnë se dallimi i përshtatshëm gjinor në pagat në Republikën e Maqedonisë së Veriut është përafërsisht 17-20%.

Të dhënat tregojnë se vetëm gjysma e grave të afta për punë (51%) janë aktive në tregun e punës në vendin tonë në krahasim me mesataren e BE-së prej 67,3%. Ngjashëm me këtë, dallimi gjinor sa i përket pjesëmarrjes në tregun e punës (në 27 pikë përqindjeje) është shumë më i madh nga dallimi mesatar gjinor në BE (11,2 pikë përqindjeje në vitin 2016). Dallimi gjinor është relativisht i ulët për të rinjtë dhe më i lartë për personat më të moshuar. Megjithatë, madje edhe për personat e rinj, dallimi është i konsiderueshëm, që tregon se nga mungesa e masave qeveritare, ky dallim do të mbetet. Një grua tipike joaktive në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka mbi 50 vjeç, me përkatësi etnike shqiptare, e martuar (ose në partneritet), jeton në një familje të varfër, jeton në qytet të vogël dhe ka vetëm arsim fillor. Prezenca e fëmijëve në shtëpi e rrit gjasën që gruaja të mbetet jashtë tregut të punës. Ndarja tradicionale e forcës së punës në amvisëritë, ku barra kryesore është kujdesi për familjen, automatikisht bie ndaj grave dhe paraqet një pengesë të madhe për aktivitetin e gruas në tregun e punës në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Me

fjalë të tjera, kërkesa e lartë dhe pritjet që gratë të kujdesen për familjen dhe anëtarët e varur të saj (fëmijë dhe persona të moshuar) rezulton me një lidhje të dobët të grave në tregun e punës. Për këtë arsye ekziston edhe një pabarazi e konsiderueshme gjinore në të ardhurat midis grave dhe burrave.⁶ Por, kur tashmë flasim për marrëdhëniet e punës, burrat dhe gratë si duket ballafaqohen me shkelje të ngjashme të të drejtave të tyre të punës dhe më të zakonshmet prej tyre do të jenë lëndë shqyrtimi në vazhdim.

E drejta e regresit për pushim vjetor (K15)

Gjatë vitit 2019, Komiteti ka regjistruar 10 raste të mospagimit të regresit për pushim vjetor ose regres të paguar në shumë më të vogël se ajo përcaktuar me ligj, në kundërshtim me Marrëveshjen e përgjithshme kolektive për sektorin privat nga sfera e biznesit. Një pjesë e punëtorëve i kanë denoncuar këto shkelje të të drejtave të tyre në Inspektoratin Shtetëror të Punës, kurse për 8 raste ekipi juridik i Komitetit ka parashtruar kërkesë në Inspektorat për zbatimin e mbikëqyrjes së jashtëzakonshme inspektuese. Inspektorati ka konstatuar shkeljen e të drejtës së regresit për pushim vjetor vetëm në një rast, kurse të gjitha përgjigjet tjera ishin negative.

Punëtori i cili te punëdhënësi ka punuar të paktën 6 muaj brenda vitit kalendarik, ka të drejtën e regresit për pushim vjetor në shumë prej të paktën 40 përqind të pagës bazë.

Punëdhënësit që kanë vështirësi në punën e tyre, duke vlerësuar gjendjen ekonomike - financiare të punëdhënësit, mund të shkojnë nën këtë minimum të garantuar, në përputhje me Marrëveshjen për ndryshimet dhe plotësimet e Marrëveshjes kolektive për sektorin privat në fushën e biznesit.⁷ Si pasojë e mosekzistimit të kriterëve të qarta rreth asaj se si konstatohet nëse kanë ekzistuar vështirësi objektive në punën e tyre dhe vlerësimi përkatës i përmasave të problemit, punëdhënësit jo rrallë e keqpërdorin dhe abuzojnë me detyrimin për pagesën e regresit për pushim vjetor. Shumë shpesh, punëdhënësit paguajnë shuma të pakonsiderueshme në emër të regresit për pushim vjetor, për çka flasin edhe rastet e dokumentuara në Komitetin e Helsinkit, ku punëdhënësit jo rrallë herë kanë paguar nga 1000, 500, madje edhe 100 denarë për regres. Rreth 7 përqind prej të gjithë rasteve të shkeljeve të të drejtave të punëtorëve që ishin denoncuar në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut kishin të bënin pikërisht me rastet në lidhje me pagesën e regresit për pushim vjetor.

⁶ Në vitin 2015 burrat kishin mesatarisht 20% të ardhura më të larta mesatare (15.692 denarë) se sa gratë (13.000 denarë).

⁷ Marrëveshja për ndryshimin dhe plotësimin e Marrëveshjes së përgjithshme kolektive për sektorin privat në fushën e ekonomisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ numër 119/2015).

Kjo rezulton me një pasiguri juridike të punëtorëve dhe pamundësi që Inspektorati Shtetëror i Punës të konstatojë shkelje të të drejtave të punëtorëve nga marrëveshja kolektive, për shkak të mungesës, së kritereve dhe procedurave të sakta për konstatimin e vështirësive në punën e punëdhënësit.

Për më tepër, për shkak të zbatimit të pasaktë dhe të pabarabartë të dispozitave që kanë të bëjnë me pushimin vjetor të punonjëseve që kanë shfrytëzuar pushimin e lindjes, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut për rastet në fjalë ka ngritur procedurë. Procedura ishte ngritur para Komisionit për interpretimin e marrëveshjes kolektive për sektorin privat në fushën e ekonomisë, për interpretimin e dispozitave kontestuese me qëllim të zbatimit të barabartë të tyre. Komisioni për interpretim vendosi se gratë që shfrytëzojnë pushim për shkak të shtatzënisë ose lindjes dhe janë në marrëdhënie pune të njëjti punëdhënësi të paktën 6 muaj brenda vitit kalendarik, kanë të drejtën e pagesës së regresit për pushim vjetor.

Rekomandim:

Për shkak të prirjes së pagesës së regresit për pushim vjetor në shuma të vogla dhe të pakonsiderueshme, medoemos duhet të definohen kritere dhe procedura të qarta për konstatimin nëse dhe në çfarë përmasash punëdhënësi në të vërtetë po ballafaqohet me vështirësi financiare në afarizmin e tij. Vetëm në atë mënyrë do të shmangen paradokset e tanishme normative me të cilët ju mundësohet punëdhënësve që në mënyrë të vazhdueshme të ketë rritje të vëllimit të punës, kurse në të njëjtën kohë të ballafaqohet me vështirësi financiare, dhe si rezultat i kësaj të paguajë regresin për pushim vjetor në shumë më të vogël se baza e përcaktuar ligjore.

Siguria dhe shëndeti në punë

Lëndimet e shpeshta të punëtorëve në vendet e tyre të punës e vënë në pikëpyetje funksionalitetin e sistemit për siguri dhe shëndet në punë. Nga të dhënat e mbledhura për lëndimet në vendin e punës dhe nga informacionet për reagimin e ISHP-së në këto raste, rezultoi se problemi nuk është nga mungesa e rregullativës ligjore por nga mungesa e zbatimit të ligjeve – dhe në raport me parandalimin e aksidenteve në vendin e punës dhe në raport me sanksionimin e lëshimeve që kanë sjellë këto incidente.

Sipas informacioneve që vazhdimisht i grumbullon Komiteti i Helsinkit nga mediat dhe nga buletinet ditore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërtimtaria është veprimtaria ku ndodhin më së shumti fatkeqësi në vendin e punës, pastaj vijojnë lëndimet te personat që kryejnë veprimtari të pavarur profesionale, respektivisht bujqit - traktoristë. Gjatë tre viteve të fundit mund të vërehet prirje shqetësuese sa i përket mbrojtjes së punëtorëve.

Në vitin 2018, sipas raportit vjetor të SHMMP-së kanë ndodhur të paktën 124 fatkeqësi në punë, nga të cilat 33 kishin qenë fatale.⁸ Në vitin 2019, mediat dhe MPB-ja njoftoi për të paktën 19 lëndime në vendin e punës me pasoja fatale, kurse Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ishte njoftuar drejtpërdrejt vetëm për një rast të procesuar të fatkeqësisë në punë me pasoja fatale. Në rastin konkret, Inspektorati Shtetëror i Punës pasi që ka konstatuar parregullsi, ka ngritur padi penale kundër realizuesit si subjekt juridik dhe kundër personit përgjegjës të subjektit juridik ku ka punuar punëtori.

⁸ Të dhënat e Institutit për shëndet publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga ana tjetër tregojnë se në vitin 2018 ka pasur të paktën 846 lëndime në vendin e punës. Ky disproporcion tregon se ekzistojnë probleme dhe dallime serioze që nga vetë grumbullimi i të dhënave. Informacionet e Institutit janë në dispozicion në faqen e tyre të internetit.

Rekomandim:

Pa angazhimin e plotë të të gjithë bartësve në sistemin e sigurisë dhe shëndetit në punë, situata nuk do të ndryshojë por përkundrazi, do të përkeqësohet edhe më tej. Në këtë drejtim, Komiteti i Helsinkit rekomandon që Inspektorati Shtetëror i Punës të bëjë një hetim të plotë për të gjitha rastet e lëndimeve në punë; ISHP-ja të identifikojë përgjegjësinë për aksidentet dhe t'i sanksionojë në mënyrë përkatëse të gjithë ata që duke mos vepruar ose duke shkelur ligjet dhe procedurat kanë lejuar që të ndodhin seritë e tragjeditë të tilla dhe punëdhënësit në përpikmëri t'i respektojnë ligjet dhe rregulloret me të cilat ofrohen kushte të sigurtë të punës, si mënyra e vetme për të parandaluar këto dhe aksidentet e ngjashme.

Mbrojtje institucionale e të drejtave të punëtorëve

Në bazë të të dhënave të grumbulluara përmes komunikimit të drejtpërdrejtë të përditshëm me punëtorët, Komiteti i Helsinkit po e monitoron dhe analizon punën e Inspektoratit Shtetëror të Punës si mbrojtje institucionale parësore e të drejtave nga marrëdhëniet e punës.

Gjatë vitit 2019, Komiteti i Helsinkit parashtrori 47 kërkesa në Inspektoratin Shtetëror të Punës. Shqetësuese ishte numri i vogël i rasteve ku Inspektorati ka konstatuar shkelje të të drejtave të punëtorëve. Në fakt, vetëm në 12 raste nga numri i përgjithshëm i kërkesave është konstatuar ndonjë shkelje e të drejtave të punëtorëve, në 33 raste përgjigjja e ISHP-së është negative, kurse për 2 kërkesa Inspektorati nuk ka dorëzuar përgjigje. Vetëm në një rast, Inspektorati ka ngritur padi penale kundër një punëdhënësi edhe atë për lëndim në vendin e punës me pasoja fatale.

Inspektorati i punës ka një rol kyç në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve edhe në procesin e garantimit të respektimit të përpiktë dhe zbatimit të dispozitave nga sfera e punës. Kur një punëtori i shkelet e drejta ose do t'i pamundësohet ushtrimi i të drejtës së tij nga ose në lidhje me marrëdhëniet e punës, atëherë mund të parashtrorë kërkesë në ISHP. Inspektorati duhet t'i përgjigjet kërkesës dhe menjëherë duhet të zbatojë mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese, kurse më së voni në afat prej 10 ditëve të punës nga pranimi i iniciativës dhe më së voni deri në 15 ditë pas përfundimit të mbikëqyrjes ta njoftojë parashtruesin për rezultatet e mbikëqyrjes inspektuese. Ky afat është i papërshtatshëm për shkak se bëhet fjalë për mbrojtje të të drejtave nga marrëdhëniet e punës që drejtpërdrejt janë të lidhura me statusin ekzistencial të punëtorëve dhe një mbrojtje e tillë ka nevojë për një përparësi dhe urgjencë të veçantë. Afati i gjatë në mënyrë shtesë e komplikon situatën e punëtorit sepse në të njëjtën kohë rrjedh edhe afati 8-ditësh për parashtrimin e kundërshtimit ose kërkesën të punëdhënësi në lidhje me shkeljen e bërë, dhe pastaj edhe afati 15-ditësh për ngritjen e kontestit gjyqësor.

Hulumtimet e Komitetit të Helsinkit treguan se ky lloj i mbrojtjes institucionale midis punëtorëve ishte jashtëzakonisht e pakënaqshme. Nga anketa e realizuar në gjithsej 839 të anketuarish, plotësisht të pakënaqur nga puna e ISHP-së janë deklaruar 64,2% e të anketuarve, kurse 12,6% e të anketuarve janë shprehur pjesërisht të pakënaqur. Konkludimi është se inspektoratet e punës nuk gëzojnë besim midis qytetarëve.⁹

⁹ Analiza e shkallës së kënaqësisë nga mekanizmat e mbrojtjes të të drejtave të punëtorëve në Republikën e Maqedonisë (2019), Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë.

Rekomandim:

Inspektorati Shtetëror i Punës gjatë vitit 2019 nuk i pranoi, as nuk i zbatoi rekomandimet e Komitetit të Helsinkit për përmirësimin e punës së tij, që do rezultonte me mbrojtje efikase të punëtorëve në ushtrimin e të drejtave të tyre. Prandaj e përsëritim se Inspektorati Shtetëror i Punës duhet:

- Të veprojë brenda një afati të arsyeshëm ndaj kërkesave të parashtruara për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese;
- Të dorëzojë dokumentacion e plotë të mbikëqyrjes së kryer inspektuese (procesverbal për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, vendim, mandat pagesë dhe të ngjashme) te parashtruesit e kërkesave për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese;
- Të fut në përdorim linja funksionale telefoni në të gjitha njësitë rajonale;
- Të avancojë bashkëpunimin me sindikatat, organizatat e punëdhënësve dhe të jetë më i hapur për bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile;
- T'i njoftojë parashtruesit për të gjitha rastet e kërkesave për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese për verdiktet e inicimit të procedurave të kundërvajtjes dhe shumën e kundërvajtjeve të shqiptuara kundër punëdhënësve që nuk kanë vepruar sipas vendimeve të inspektoratit dhe që nuk i kanë larguar shkeljet e konstatuara të të drejtave të punëtorëve.

Përvoja dhe arritje krahasuese ndërkombëtare

Në vitin 2019, Organizata Ndërkombëtare e Punës e publikoi Raportin e saj vjetor për zbatimin e konventave dhe rekomandimeve të saj, i hartuar nga ana e Komitetit të ekspertëve.¹⁰ Nga Republika e Maqedonisë së Veriut ishte kërkuar të dorëzohj 16 raporte, nga të cilat shteti ka dorëzuar vetëm 10 sosh. Për konventat që shteti nuk ka dorëzuar raport i veçojmë:

- *Konventa numër 98 për të drejtën e organizimit dhe marrëveshjes kolektive e vitit 1949* – Komiteti nga Qeveria e RMV-së kërkoi që të vazhdojë informimin mbi zbatimin e Konventës në praktikë, përfshi edhe dorëzimin e të dhënave statistikore për numrin e marrëveshjeve kolektive në sektorin privat dhe publik dhe numrin e punëtorëve të përfshirë me këto marrëveshje.
- *Konventa numër 111 për diskriminimin (pjesa e punësimit dhe profesionit) e vitit 1958* – Republika e Maqedonisë së Veriut nuk është përgjigjur dhe nuk i ka zbatuar komentet e Komitetit të vitit 2015 sa i përket zbatimit të kësaj Konvente. Për këtë arsye, Komiteti edhe një herë nga Qeveria kërkoi të dorëzohj informacion për masat e ndërmarra me rastin e zbatimit të Ligjit për mundësi të barabarta të burrave dhe grave dhe kontributi i saj në arritjen e barazisë gjinore në sektorin privat dhe publik. Njëherit, Komiteti kërkoi nga Qeveria që të dorëzohj informacion mbi masat e ndërmarra në praktikë për parandalimin dhe adresimin e ngacmimit seksual në vendin e punës dhe të informojë mbi procedurat për mbrojtje nga ngacmimi seksual në vendin e punës para institucioneve përgjegjëse.
- *Konventa numër 81 për inspektoratin e punës e vitit 1947 dhe Konventa numër 129 për inspektoratin e punës (në bujqësi) e vitit 1969* – Komiteti nga Qeveria ka kërkuar të dorëzohj informacion mbi aktivitetet e ndërmarra të inspektorëve të punës për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve të huaj në rastet kur ata gjenden para situatave të pavolitshme. Komiteti në mënyrë shtesë ka kërkuar informacion edhe për numrin e rasteve ku punëtorët e huaj kanë arritur t'i mbrojnë të drejtat e tyre të punës siç janë shlyerja e pagave të papaguara dhe kontributeve për sigurim social.

¹⁰ Organizata Ndërkombëtare e Punës, *Raporti i Komitetit të ekspertëve për zbatimin e konventave dhe rekomandimeve, viti 2019* [raporti është në dispozicion në: https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_norm/---relconf/documents/meetingdocument/wcms_670146.pdf, qasja e fundit më 26.01.2020].

Në raport Komiteti thekson se është shqetësuese mungesa e informacionit nga ana e vendit tonë, sa i përket konventave dhe rekomandimeve të ONP-së.



**PUNONJËSET NË
INDUSTRINË E
TEKSTILIT**

Problemet shumëvjeçare me shkeljen e vazhdueshme të të drejtave të punës së punonjëseve të tekstilit dhe mobingu nga ana e punëdhënësve, ndërgjegjësimi dhe informimi relativisht i ulët për të drejtat e tyre të punës dhe mungesën e besimit në institucionet e sistemit i bëjnë ata veçanërisht të rrezikuar dhe të ndjeshëm ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre të punës. Edhe vitin e kaluar, punonjëset në industrinë e tekstilit janë ndër gratë punëtore me pagë më të ulët në vend, me pothuajse 60% paga mesatare më të ulët se paga mesatare në nivelin shtetëror, kështu që për shkak të të ardhurave të ulëta kanë qasje të kufizuara në drejtësi dhe përballen me vështirësi në adresimin e shkeljeve të të drejtave të tyre të punës. Për më tepër, punonjëset në industrinë e tekstilit nuk kanë qenë asnjëherë të përfshirë drejtpërdrejt në proceset e hartimit të politikave që prekin drejtpërdrejt ato, siç janë Ligji për marrëdhëniet e punës, Ligji për pagë minimale, Marrëveshja e përgjithshme kolektive për sektorin privat në sferën e ekonomisë dhe të ngjashme dhe e gjithë kjo rezulton me miratimin e politikave restriktive që i rregullojnë të drejtat e punës së punonjëseve në industrinë e tekstilit.

Pikërisht për këtë, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut edhe në vitin 2019 vazhdoi punën në parandalimin dhe uljen e shkeljeve të të drejtave të punës së punonjëseve të tekstilit përmes përforcimit të tyre juridik dhe përforcimit të vetëpërfaqësimit të tyre. Komponente të rëndësishme për realizimin e këtyre qëllimeve janë ofrimi i ndihmës

juridike falas dhe ndihmës para-juridike të punonjëseve në industrinë e tekstilit të cilat kanë pësuar shkelje të të drejtave të tyre të punës. Kjo do të rezultojë në përmirësimin e qasjes në drejtësi të punonjëseve në industrinë e tekstilit, do ta ngrit ndërgjegjen për gjendjen me të drejtat e tyre dhe do ta rrit pjesëmarrjen e tyre në proceset e miratimit të politikave që i rregullojnë të drejtat e punëtorëve.

Vetëpërfaqësimi

Në vitin 2019 punonjëset në industrinë e tekstilit për herë të parë ishin përfshirë në proceset e vetëpërfaqësimit për miratimin e politikave dhe ligjeve në nivel kombëtar me të cilat rregullohen të drejtat e tyre të punës. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut si pjesë e grupit të punës për hartimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për marrëdhëniet e punës, arriti që t'i adresojë propozimet dhe idetë e punonjëseve në industrinë e tekstilit për ndryshime dhe përmirësime të ligjeve, që ishin detektuar përmes punës në terren të parajuristëve të angazhuar nga rradhët e punonjëseve në industrinë e tekstilit.

Propozimet kishin të bënin me definimin e rasteve kur punëdhënësit mund të nënshkruajnë kontratë punësimi për kohë të caktuar me punëtorët; shndërrimi i kontratës së punësimit nga kontrata me kohë të caktuar në kontratë për kohë të pacaktuar të jetë detyrim ligjor i punëdhënësit, në rast se përmbushen kushtet ligjore për një gjë të tillë; qartësimi i

afatit kur punëtori duhet të përmirësojë punën e tij, në rastet kur punëdhënësi e ka njoftuar se nuk është i kënaqur nga mënyra e kryerjes së detyrave të punës; zgjatja e afatit për parashtrimin e kundërshtimit ndaj vendimeve për ndërprerje të kontratës së punësimit me afat pushimi nga puna dhe ndërprerjes së kontratës së punësimit pa afat pushimi nga puna ose vendimet për largim nga punëdhënësi prej 8 në 15 ditë; saktësimi i procedurës disiplinore për konstatimin e shkeljes në detyrat e punës, rendit dhe disiplinës së punëtorit në punë, para shqiptimit të gjobës në para; zgjatja e afatit për parashkrimin e kërkesave monetare nga marrëdhëniet e punës nga 3 në 5 vite. Të gjithë këto rekomandime janë përfshirë në versionin e fundit punues të Projekt-ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për marrëdhëniet e punës.

Në vitin 2019 është vërejtur një rritje e ndërgjegjes së punonjëseve në industrinë e tekstitit sa i përket organizimit sindikal. Me ndihmën dhe ndërmjetësimin e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ishte themeluar njësi themelore sindikale në nivel punëdhënësi në një fabrikë tekstili në Dellçevë. Vitin e kaluar, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka punuar edhe në terren për t'i informuar punonjëset në industrinë e tekstitit për të drejtat e tyre të punës, përmes mbajtjes së punëtorive informuese, kryesisht në qytetet e pjesës lindore të vendit. Komiteti e ka mbështetur edhe [protestën në Shtip](#), e organizuar pas paralajmërimeve të Kllasterit të industrisë së tekstitit për zgjatjen e orarit të punës dhe disa kërkesa të tjera që drejtpërdrejt i preknin të drejtat e punonjëseve në industrinë e tekstitit.



5 Nga protesta e punonjëseve në industrinë e tekstitil në nëntor të vitit 2019

Ndihmë juridike dhe para-juridike falas

Në vitin 2019 ishin dokumentuar 634 raste shkeljesh të të drejtave të punës të 1871 punonjëseve dhe punonjësve të tekstitil në 60 fabrika dhe punëtori tekstitil në vendin tonë. Shkeljet u referoheshin: pagave të papaguara, shtesave të papaguara të pagës, punës së papaguar jashtë orarit, punës jashtë orarit mbi pragun maksimal të lejuar ligjor, shkeljes së të drejtës për shfrytëzimin e pushimit vjetor dhe javor, ndërprerjes së jashtëligjshme të marrëdhënies së punës, mobingut, punës në kushte të

papërshtatshme shëndetësore, sanitare dhe sigurie, regresit të papaguar për pushim vjetor (K15).

Ndihma juridike për rastet e dokumentuara përbëhej prej këshillimit juridik, informimit të punonjëseve për të drejtat e tyre të punës dhe ngritjes së procedurës për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës. Komiteti i Helsinkit ka ngritur 22 procedura administrative për mbikëqyrje të

jashtëzakonshme inspektuese pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës. Nga procedurat e ngritura, në 9 raste Inspektorati ka konstatuar shkelje të të drejtave të punës dhe i ka obliguar punëdhënësit që t'i largojnë ato shkelje, në 12 raste nuk ka konstatuar shkelje të drejtash, kurse vetëm 1 procedurë është akoma në zhvillim e sipër. Ky është një ndryshim dhe përmirësim pozitiv sa i përket efikasitetit të veprimit të Inspektoratit Shtetëror të Punës, i cili në vitin 2017 dhe 2018 administronte procedura shumë të gjata dhe të ngadalta të inspektimeve të jashtëzakonshme dhe jo rrallë, madje as nuk përgjigjej ndaj kërkesave të parashtruara për ngritjen e mbikëqyrjeve të jashtëzakonshme juridike.

Megjithatë, mbetet çështja e efikasitetit të mbrojtjes që e ofron Inspektorati, respektivisht nëse dhe në ç'masë e konstaton gjendjen faktike gjatë kryerjes së

mbikëqyrjeve, sa i respektojnë punëdhënësit urdhëresat e dhëna të Inspektoratit dhe në çfarë shkalle janë të kënaqur punonjëset në industrinë e tekstilit dhe punëtorët sa i përket cilësisë së drejtësisë së fituar. Edhe më tej hasen situata kur konstatohen parregullsi dhe mangësi te punëdhënësi, ndërsa sanksioni i vetëm është shqiptimi i gjobës, të cilën punëdhënësi e paguan pa asnjë problem dhe vazhdon edhe më tej të shkel të drejtat e punës së punëtorëve. Punonjëset përmes procedurave administrative, që janë falas dhe lehtë të aksesueshme, edhe më tej nuk mund t'i realizojnë kërkesat monetare nga punëdhënësit e tyre. Nga ana tjetër, për shkak të të ardhurave relativisht të ulëta dhe rrezikut social, punonjëset në industrinë e tekstilit akoma kanë qasje të kufizuar në drejtësi sa i përket mbrojtjes gjyqësore edhe përkundër miratimit të ndryshimeve dhe plotësimeve në Ligjin për ndihmë juridike falas.

Rekomandime:

- Inspektorati Shtetëror i Punës duhet të vendosë një sistem për parashtrimin e nismave anonime për inicimin e mbikëqyrjeve të jashtëzakonshme inspektuese, në mënyrë që të inkurajojë punonjëset e tekstilit të denoncojnë shkeljet e të drejtave të punëtorëve.
- Njësitë rajonale të Ministrisë së Drejtësisë në bashkëpunim me sindikatat dhe shoqatat civile, përmes takimeve informative duhet t'i njoftojnë punonjëset e tekstilit mbi mundësitë për marrjen e ndihmës juridike falas sipas Ligjit për ndihmë juridike falas në rastet e shkeljeve të të drejtave të punëtorëve. Në këtë mënyrë, punonjëset e tekstilit do të motivohen që të inicojnë procese gjyqësore në raste kur t'ju shkelen të drejtat e punëtorëve.
- Inspektorati Shtetëror i Punës, Drejtoria e të Hyrave Publike dhe Policia Financiare duhet të vendosin një bashkëpunim të koordinuar në trajtimin e rasteve të shkeljeve të të drejtave të punëtorëve, veçanërisht në ata raste që kanë të bëjnë me kthimin e parave nga punëtorët te punëdhënësit, pagesën e pagave në dorë, mospagimin e pagave, kontributeve dhe shtesave të pagës.
- Përfshirje më të madhe të Sindikatës së punëtorëve të industrisë së tekstilit, lëkurës dhe këpucëve në informimin, ndërgjegjësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Sindikata duhet të organizojë më shpesh trajnime dhe takime me punonjëset e tekstilit në drejtim të fuqizimit të tyre juridik, por edhe në ndërgjegjësimin e tyre për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Përveç kësaj, Sindikata duhet të punojë në motivimin e punonjëseve të tekstilit për organizim sindikal, duke i informuar mbi përparësitë e organizimit sindikal.

BARAZIA

GJINORE

Ndryshime të dispozitave ligjore

Projekt-Ligji për ndërprerjen e shtatzënisë¹¹ që u dorëzua në vitin 2018, u miratua në muajin maj të këtij viti. Ligji i vitit 2013, i cili për shkak të përmbajtjes së tij dhe miratimit me procedurë të shkurtuar shkaktoi reagime të ashpra te një pjesë e madhe e sektorit joqeveritar dhe në përgjithësi të qytetarëve, në mënyrë të konsiderueshme e vështirësoi qasjen në abort përmes vështirësimit dhe birokratizimit të procedurës për ndërprerje të shtatzënisë.

Me Ligjin e ri janë hequr një pjesë e pengesave administrative siç janë këshillimi i detyrueshëm dhe pritja treditore pas këshillimit, si dhe sigurimi i vërtetimeve nga ana e grave në rastet e përdhunimeve ose gjendjes së pavolitshme sociale, me çrast deklaratat personale të grave do të jenë të mjaftueshme që institucioni shëndetësor të jep shërbimin e kërkuar shëndetësor. Ligji parashikon që ndërprerja e shtatzënisë të mund të bëhet deri në javën e 12-të gjestacionale, me dakordim me shkrim nga gruaja shtatzënë, kurse formimi i Komisionit të shkallës së parë është zgjatur nga java e 12-të në javën e 22-të gjestacionale të shtatzënisë. Nëse gruaja shtatzënë është e mitur dhe me aftësi të marrë veprimi, ndërprerja e shtatzënisë mund të bëhet me dakordim me shkrim nga ana e prindit, respektivisht kujdestarit të gruas shtatzënë. Risia në Ligjin e ri është aborti medikamentoz, ku për herë të parë ofrohet mundësia për ndërprerjen e shtatzënisë deri në javën e 9-të gjestacionale me metodën medikamentoze dhe në institucionin e mbrojtjes parësore shëndetësore. Në këtë mënyrë qasja në abort do të zgjerohet në më shumë qytete dhe do të kontribuojë në uljen e shpenzimeve rrugore të grave.

Në vitin 2019 ishte formuar grupi i punës për hartimin e Ligjit të ri për mundësi të barabarta midis grave dhe burrave, ku do të merr pjesë edhe përfaqësuesja e Komitetit të Helsinkit. Nevoja për miratimin e Ligjit të ri ishte rezultat i efekteve të kufizuara të ligjit të tanishëm, veçanërisht në nivel lokal. Sipas rekomandimeve nga raporti i Komitetit për eliminimin e diskriminimit ndaj grave (Komiteti CEDAW¹²) i vitit 2018, duhet të përcaktohet korniza kohore dhe prioritetet tematike sa i përket amandamenteve të Ligjit, në përputhje me parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit në të gjitha sferat e mbuluara në Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW), në bashkëpunim me të gjithë bartësit kryesorë, përfshi edhe shoqërinë civile.¹³ Rekomandimet e adresojnë nevojën për zhvillimin e planit për zbatim të targetuar të Ligjit, duke u fokusuar te gratë në mjediset rurale, romët, gratë refugjate dhe kërkuese azili, gratë në prostitucion dhe gratë me aftësi të kufizuara.

¹¹ Gazeta zyrtare e RMV-së, nr. 101/2019

¹² CEDAW – Convention on Elimination on all Forms of Discrimination against Women

¹³https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW/C/MKD/CO/6&Lang=En

Përgjatë këtij viti ishin bërë arritje të rëndësishme sa i përket përmbushjes së objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara në Planit kombëtar të veprimit për zbatimin e Konventës së Stambollit 2018-2023 (PKV). Në atë drejtim, në vitin 2018 ishin themeluar tri Qendra për strehimin e viktimave të dhunës seksuale. Në Qendrën e Shkupit në vitin 2018 ishin denoncuar tre raste, kurse në vitin 2019 pesë raste, prej të cilave vetëm për një rast është argumentuar se është kryer vepra penale „përdhunim”. Komiteti i Helsinkit, së bashku me rrjetin kombëtar kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe me bartësit përkatës institucionalë, në mënyrë të vazhdueshme po punon në ngritjen e ndërgjegjes për ekzistencën e tyre, si dhe në avancimin e protokollove për funksionimin e tyre.

Megjithatë, njëri prej ligjeve kryesore që ishte parashikuar në PKV-në – **Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje**, në hartimin e të cilit kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të Komitetit të Helsinkit dhe i cili parashikohej të miratohet deri në fund të vitit, nuk u vendos për t’u votuar në Kuvend për shkak të shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare më 12 prill 2020. Miratimi i këtij ligji në mënyrë të konsiderueshme do ta përmirësonte mbështetjen institucionale dhe gjithëpërfshirëse të viktimave nga dhuna me bazë gjinore.

Qëllimi i miratimit të këtij Ligji ishte tejkalimi i pengesave dhe mangësive në Ligjin ekzistues për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, duke siguruar barazi, largimin e stereotipeve për rolet e gjinive, parandalimin e të gjitha formave të dhunës në familje me bazë gjinore, dhe përcaktimin e masave dhe aktiviteteve për mbrojtjen e viktimave të këtij lloji të dhunës. Me këtë ligj rregullohet veprimtaria e institucioneve dhe koordinimi i tyre me organizatat dhe për herë të parë parashikon se duhet të veprojnë me kujdes të veçantë. Teksti i Ligjit të ri përfshin forma të reja të dhunës që janë pjesë e Konventës së Stambollit dhe shprehimisht i definon nocionet dhunë ndaj grave dhe dhunës në familje bazuar në gjini, dhe njëherit parashikon edhe mbështetje për të gjitha kategoritë e grave të rrezikuara, siç janë gratë trans-gjinore, gratë përdoruese të drogës, gratë shtatzënë, gratë rome etj.

Me ratifikimin e Konventës së Stambollit, Republika e Maqedonisë së Veriut e merr edhe obligimin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal, por edhe të ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore, që është me rëndësi të veçantë të përfundohet në dy vitet e ardhshme para procedurës së planifikuar të vlerësimit të Grupit të ekspertëve për veprim kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës familjare (GREVIO)¹⁴ për vendin tonë. Në ndërkohë ishte formuar grupi i punës për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal në drejtim të përkrahimit të veprave të reja penale dhe zbatimit të dispozitave të parashikuara në Konventën e Stambollit siç janë dhuna në familje,

¹⁴ Group of Experts on Action against Violence against Women and Domestic Violence

dhuna psikologjike, ngacmimi seksual, sakatimi gjenital, përndjekja dhe aktet seksuale jokonsensuale. Njëherit, Kodi Penal është neutral në aspektin gjinor sa i përket gjuhës së përdorur, respektivisht nuk e njih pabarazinë gjinore dhe stereotipet gjinore, të cilat janë edhe shkak kryesor që disa vepra penale nuk janë rregulluar në Konventë. Për më tepër, në Kodin Penal duhet qartë të përkufizohet se ç'është „dhunë me bazë gjinore” dhe ç'është „dhunë ndaj grave”.

Identifikimi i dhunës ndaj grave /dhunës me bazë gjinore/dhunës në familje dhe besimit në institucionet përgjegjëse edhe më tej është në nivel të pakënaqshëm. Hulumtimi rajonal i kryer nga ana e OSBE-së për gjendjen me dhunën e bazuar në gjini në vendin tonë tregon faktin se tri nga pesë (60%) gra konsiderojnë se dhuna ndaj grave është e zakonshme, kurse tri nga dhjetë konsiderojnë se ky është një fenomen shumë i shpeshtë.¹⁵ Kjo nënkupton se ka nevojë për një edukim të gjithpërfshirës dhe ngritje të ndërgjegjes, para së gjithash për identifikimin e dhunës si dhe për rritjes së shkallës së besimit të institucionet. Gjatë vitit 2019, Komiteti i Helsinkit ka punuar aktivisht në këtë sferë përmes punës me 60 përfaqësues të institucioneve të përfshira në sistemin për parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe mbrojtjes së viktimave, por ajo që u konstatua si urgjente ishte vendosja e qasjes sistimore ndaj problemit.

Për t'i përmbushur standardet e përshkruara me Konventën e Stambollit ka nevojë për hapjen e disa qendrave shtesë për viktimat e dhunës seksuale dhe asaj me bazë gjinore.¹⁶ Njëherit, Komiteti i Helsinkit u bën thirrje institucioneve që të angazhohen për miratimin sa më të shpejtë të këtij ligji, menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve dhe formimit të Qeverisë.


Përfaqësimi ndërkombëtar

Përkundër faktit se Republika e Maqedonisë së Veriut është njëra ndër shtetet që ka pranuar Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW), si dhe Protokollin fakultativ të saj, në praktikë detyrimet e shtetit në raport me Konventën nuk u avancuan, prandaj edhe ishte kritikuar nga ana e organizatave të shoqërisë civile, ekspertëve juridikë dhe praktikantëve juridikë.

¹⁵ <https://www.osce.org/mk/secretariat/424409?download=true>

¹⁶ <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-north-macedonia-report.pdf>

Në kuadër të projektit „Gratë kanë të drejta!”, Komiteti i Helsinkit më 25 maj 2019 parashtrio kundërshtim në Komitetin CEDAW, që në fakt paraqet komunikimin e parë të Republikës së Maqedonisë së Veriut me këtë Komitet. Rasti i cili ishte identifikuar si i përshtatshëm për përfaqësim para Komitetit, më parë ishte procesuar para gjykatave vendase, dhe ishte mbështetur financiarisht nga ana e Shoqatës për edukim shëndetësor dhe hulumtim HERA. Rasti ka të bëjë me dy gra-rome të cilëve u ishte pamundësuar e drejta e mbrojtjes shëndetësore, respektivisht u ishte kufizuar qasja në shërbimet gjinekologjike. Dorëzimit të kundërshtimit i paraprinë një seri trajnimesh me përfshirjen e disa organizatave që punojnë në këto çështje, kurse Komiteti i Helsinki përgatiti një Manual për parashtrimin e kundërshtive në Komitetin CEDAW.¹⁷ Nëse kundërshtimi pranohet si i bazuar, atëherë shteti duhet të sigurojë trajtim të barabartë në shërbimet shëndetësore për të gjitha kategoritë e qytetarëve dhe t’i zbatojë rekomandimet e Komitetit.



Në vitin 2019, në Komitetin e Helsinkit ndihmë kanë kërkuar 31 viktima të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. 12 sosh na kanë kontaktuar përmes telefonit, kurse 19 prej tyre na kanë vizituar personalisht në zyrën për ndihmë juridike falas.

7 viktima, para institucioneve përgjegjëse ishin shoqëruar nga përfaqësues të Komitetit të Helsinkit (stacione policore dhe qendra për punë sociale), për të denoncuar dhunën në familje.

¹⁷ <https://mhc.org.mk/publicationsanalyzes/prirachnik-za-fakultativniot-protokol-kon-cedav/>

Gjatë këtij viti, Komiteti i Helsinkit realizoi një **fushatë video**, e titulluar si “A e di?”¹⁸, e cila përbëhej nga tetë video informative dhe edukative, të dedikuara për ngritjen e ndërgjegjes për Konventën dhe të cilat prezantojnë të dhëna për pabarazinë gjinore në vend, në sfera të ndryshme: dhuna në familje, tregu i punës, arsimi, politika etj.

Bazuar në dëshmitë personale të viktimave si dhe rasteve të shoqërimit të viktimave nga dhuna, Komiteti i Helsinkit konstatoi një shkallë të lartë të mosveprimit të nëpunësve të QPS-së dhe MPB-së, gjykatësve, prokurorëve, sjellja e të cilëve në mënyrë shtesë kontribuon për viktimizimin e dyfishtë të viktimave. Jo vetëm që sjellja e tyre është e papërgjegjshme, në shumë raste reagimet e tyre janë të ngadalta, të paligjshme dhe joprofesionale. Numri i vërtetë i viktimave të dhunës nuk përputhet me numrin e rasteve të denoncuar në Komitetin e Helsinkit, që është rezultat i mosinformimit të viktimave nga ana e institucioneve si dhe sjelljes së tyre ndaj viktimave që rëndom janë inkurajuese. Në këtë drejtim duhet një angazhim për ofrimin e mbrojtjes efikase nga dhuna, që do të kontribuonte në rritjen e besimit te institucionet.

¹⁸ <https://mhc.org.mk/news/promocija-na-video-kampanjata-dali-zna/>



QPS: „Pse i ke lindur dy fëmijë, nëse të rrah“

QPS: „Pse denoncon tani, kur të rrah për një periudhë të gjatë kohore?“

QPS: „Pse ke filluar të jetosh me të dhe ke lindur dy fëmijë, kur e ke ditur se është një boksier profesional?“

QPS: „Pse je martuar me të, nëse ke pasur njohuri se është përdorues i mjeteve narkotike dhe se është një person agresiv?“

MPB: „Nuk mund të inicosh procedurë për dhunë në familje, nuk ke asnjë lëndim të dukshëm, kurse ai ka gërvishtje nga ana yte“ (gërvishtjet janë nga vetëmbrojtja e viktimës)

MPB: „Nëse vëllau yt nuk vjen derisa jemi këtu, nuk mund të presim më shumë“ (nëpunës policor në shtëpinë e viktimës dhe dhunuesit)

MPB: „Për shkak sepër herë të parë denoncon dhunë në familje, vetëm do ta paralajmërojmë, nuk mund të ndërmarim asgjë më shumë.“

Gjykata: „Nëse nuk je e sigurt se dëshiron të inicosh procedurë për dhunë në familje, hiq dorë tani, të mos i bësh shpenzime shtetit.“

Gjykata: „Ju jeni të rinj, keni fëmijë, duhet të pajtoheni.“


Aktivizmi dixhital

Në kuadër të fushatës „16 ditë aktivizëm kundër dhunës me bazë gjinore“, në fokusin e të cilës ishte ngacmimi seksual, dhuna dhe përdhunimi nën parullën „Generation equality stands against rape!“, platforma feministe „Meduza“ realizoi një aksion guerilas nën hashtagun #PseNukDenoncova. Nëpër faqe me hashtagun #PseNukDenoncova ishin shpërndarë histori viktimash të dhunës në disa vendndodhje në Shkup, të cilat më tej ishin shpërndarë edhe në rrjetet dhe mediat sociale. Fushata kishte për qëllim të ndërpresë heshtjen për dhunën seksuale, përmes hapjes së hapësirës publike për të gjithë ata që nuk kanë pasur guxim të bisedojnë për atë çka ju ka ndodhur, si dhe për arsyet e mosdenoncimit të dhunës. Fushata në mediat sociale kishte mbulim prej rreth gjysmë milioni, me çka na tregoi se edhe më tej dhuna është prezente dhe është tabu, si dhe për frikën dhe turpin për të denoncuar të njëjtën. Rezultatet e fushatës treguan për disa fakte dështuese, se dhuna seksuale është e përhapur shumë më gjerë se ç’kemi parë dhe denoncuar, dhe se viktimat akoma nuk kanë guxim të bisedojnë për traumat e përjetuara, kurse edhe më pak ta denoncojnë dhunën.





NDIHMË
JURIDIKE
FALAS



Sa i përket të vërtetës dhe drejtësisë, nuk ekziston dallim midis problemeve të mëdha dhe të vogla, sepse të gjitha çështjet rreth trajtimit të njerëzve janë të njëjta.

-Albert Ajnshtajn -

Themeli i ekzistimit të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut është ofrimi i ndihmës juridike falas grupeve dhe qytetarëve të rrezikuar dhe marginalizuar që janë në rrezik social. Sipas Hulumtimit për perceptimin dhe njohuritë e qytetarëve mbi Ligjin për ndihmë juridike falas¹⁹ është krijuar Reaktor – hulumtim në veprim, ku 92,5% e të anketuarve janë përgjigjur se nuk kanë dëgjuar për shoqata dhe

organizata që ofrojnë ndihmë juridike falas. Megjithatë, Hulumtimi tregon se Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut është udhëheqës në këtë sferë, si organizatë e cila është më e njohur dhe më e disponueshme për ofrimin e ndihmës juridike falas. Kjo e bën Komitetin e Helsinkit një organizatë më të përshtatshme për grumbullimin e të dhënave reprezentative sa i përket kërkesve të ndihmës juridike falas.

Në vitin 2019, në faqen e tij të internetit, Komiteti i Helsinkit ka publikuar raporte mujore për gjendjen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Raportet ishin përgatitur mbi bazën e të dhënave të grumbulluara nga kërkesit e ndihmës juridike dhe mangësive të identifikuara të sistemit. Këto raporte monitorimi, të promovuara në mediat elektronike dhe në dispozicion për përdorim të gjerë publik, i kanë njoftuar vendimmarrësit (në veçanti Ministria e Drejtësisë, si institucion përgjegjës) për rekomandimet tona për avancimin e sistemit të ndihmës juridike falas.

Duke i vendosur së pari çështjet parësore të rëndësishme për Bashkimin Evropian, dhe në drejtim të harmonizimit të legjislacionit tonë me atë të Bashkimit dhe mbrojtjes së vlerave të tij themelore, në vitin 2009 ishte miratuar për herë të parë Ligji për ndihmë juridike falas i cili kishte hyrë në fuqi vitin e ardhshëm. Hulumtimi i fundit për perceptimin publik dhe njohuritë e qytetarëve mbi Ligjin për ndihmë juridike falas, tregoi se vetëm 1,1% e tërë popullsisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut i plotëson kushtet ligjore për marrjen e ndihmës juridike falas.²⁰ Sistemi për ofrimin e ndihmës juridike falas kishte mangësi dhe dobësi serioze, kurse Ligji

¹⁹ Reaktor – hulumtim në veprim, *I hulumtimi për perceptimin publik dhe njohuritë e qytetarëve për Ligjin për ndihmë juridike falas*, FSHHM, viti 2016.

²⁰ Ibid.

për ofrimin e ndihmës juridike falas nuk arriti të përmbush objektivin e tij – mbrojtjen e parimit të qasjes së barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët.

Për shkak të kësaj, në vitin 2019 ishte miratuar Ligji i ri për ndihmë juridike falas, i cili hyri në fuqi në muajin tetor të të njëjtit vit. Teksti i përmirësuar i Ligjit mbulon përfshirje më të gjerë të qytetarëve që i plotësojnë kushtet për marrjen e ndihmës juridike falas. Komiteti i Helsinkit në mënyrë sistemore po e monitoron procesin e zbatimit të Ligjit të ri dhe tërë sistemit të ndihmës juridike falas në përgjithësi.

Komiteti i Helsinkit vepron në drejtim të fuqizimit ligjor dhe mbështetjes juridike për qytetarët, që nga themelimi i tij në vitin 1994. Nga viti 2016, Komiteti i Helsinkit është regjistruar si shoqatë e autorizuar për ofrimin e ndihmës parësore juridike në pajtim me Ligjin për ndihmë juridike falas.

- Gjatë vitit 2019, Komiteti i Helsinkit u ka siguruar ndihmë juridike 400 qytetarëve, në sferën e marrëdhënieve të punës dhe aksesit në punësim, dhunës në familje dhe me bazë gjinore, marrëdhënieve familjare, diskriminimit, mbrojtjes sociale, gjuhës së urrejtjes dhe veprave nga urrejtja.
- Në vitin 2019, 224 burra dhe 176 gra kanë kërkuar ndihmë juridike falas. Nga to, 346 maqedonë, 17 romë, 22 shqiptarë, 7 boshnjakë, 6 turq dhe 2 serb.
- Për më tepër, Komiteti i Helsinkit ka parashtruar 4 kërkesa për ndihmë dytësore juridike në Ministrinë e Drejtësisë, për zgjidhje martese për shkak të dhunës në familje, marrjen e të drejtës së prindit, kujdesin e fëmijës dhe sundimit të çrregulluar. Tri nga kërkesat e parashtruara ishin aprovuar, kurse vetëm një kërkesë ishte refuzuar dhe ankimuar para institucionit përgjegjës.

Komiteti është në kontakt me grupet më të rrezikuara dhe të marginalizuara, i fuqizon njohuritë e tyre për të drejtat e tyre dhe mekanizmat për mbrojtjen e tyre, dhe kontribuon në gëzimin e qetë të të drejtave të tyre në shoqëri si një tërësi. Por, ky obligim së pari gjendet te shteti. Republika e Maqedonisë së Veriut ka për obligim që t'ju ofrojë të gjithë individëve qasje të pandërprerë dhe të barabartë në mekanizmat përkatëse, të pavaruara dhe të paanshme gjyqësore dhe jashtëgjyqësore. Qasja në drejtësi nuk është vetëm një e drejtë themelore e njeriut. Ajo gjithashtu është edhe një parakusht thelbësor për mbrojtjen dhe avancimin e të gjitha të drejtave të tjera qytetare, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale.

Sipas të dhënave të fundit të Entit Shtetëror të Statistikës²¹, në vitin 2018, norma e personave të varfër në Republikën e Maqedonisë së Veriut ishte 21.9%. Numri i personave që jetojnë nën pragun e varfërsisë ishte 455.000, respektivisht 1/5 e numrit të përgjithshëm të popullsisë. Prandaj, krijimi i një sistemi gjithëpërfshirës të drejtësisë që merr parasysh çekuilibrin e fuqisë dhe të ardhurave është thelbësore për të siguruar qasje në drejtësi për qytetarët e varfër. Kjo nënkupton mekanizma dhe ligje mirë funksionale gjyqësore dhe jashtëgjyqësore, që do të reflektonin interesat dhe nevojat e secilit, para së gjithash të qytetarëve në rrezik social. Shteti ka për detyrë të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që personat që jetojnë në varfëri nuk janë të kufizuar nga gëzimi i të drejtave të tyre si rezultat i pengesave të pakapërcyeshme në qasjen sistemore në drejtësi.

Në këtë drejtim, Republika e Maqedonisë së Veriut edhe këtë vit nuk ka marrë masa të mjaftueshme për të njohur qytetarët me të drejtat e tyre dhe mekanizmat për mbrojtjen e tyre. Nga të dhënat e mbledhura përmes bisedave me aplikantët për ndihmë juridike, ka rezultuar se edhe nëpunësit civilë nuk i njohin sa duhet të drejtat e qytetarëve për të mundësuar ushtrimin ose mbrojtjen e tyre. Gjatë vitit 2019, Ministria e Drejtësisë zhvilloi trajnime për personat zyrtarë të njësive rajonale, të cilët do të vendosin në procedurat për miratimin e ndihmës dytësore juridike. Por, deri më tani kjo ka qenë e pamjaftueshme për të kapërcyer krizën sistemore të qasjes efektive në drejtësi. Përkatësisht, është e nevojshme të sigurohet trajnim profesional për të gjithë ofruesit e shërbimeve që kontribuojnë në ushtrimin e të drejtave të qytetarëve. Kjo do të thotë që përveç punonjësve në Ministrinë e Drejtësisë, trajnime për edukime shtesë janë të nevojshme edhe për organet e sistemit gjyqësor, përfshi edhe nëpunësit policorë, gjykatësit dhe nëpunësit e gjykatës, avokatët, si dhe nëpunësit civilë dhe ofruesit e shërbimeve publike. Për më tepër, ata duhet të sensibilizohen për të punuar me një kategori të rrezikuar qytetarësh siç janë njerëzit që jetojnë në varfëri.

Vetëm eliminimi i të gjitha këtyre mangësive mund të çojë në një qasje efektive dhe të barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët, e cila i merr parasysh përvojat, nevojat dhe kufizimet individuale të kategorive më të rrezikuara.

²¹ Enti Shtetëror i Statistikës, *Treguesit laikenë të varfërisë në vitin 2018 – të dhëna definitive*, 23.12.2019 [e tërë komunikata mund të gjendet në: http://www.stat.gov.mk/pdf/2019/4.1.19.116_mk.pdf].



Gjatë vitit 2019, Komiteti i Helsinkit zbatoi një fushatë me emërtimin “Bëhu hero i dikujt! Dhuro për ndihmë juridike.” Fushata është dedikuar për krijimin e një fondi të qëndrueshëm për ndihmë juridike, përmes të cilit Komiteti i Helsinkit do të veprojë edhe në terren, jashtë Shkupit që t’ju ndihmojë edhe atyre qytetarëve që nuk kanë mundësi ta vizitojnë zyrën tonë dhe të cilët me të vërtetë kanë nevojë për një mbështetje të tillë.



**QENDRA PËR
MBËSHTETJE LGBTI**

Gjatë vitit 2019, ne po vërejmë lëvizje të rëndësishme drejt AVANCIMIT të të drejtave të njeriut të personave LGBTI në vendin tonë. Aktivitetet brenda programit për përfaqësimin e Qendrës për mbështetje LGBTI kishin për qëllim avancimin e legjislacionit dhe qasjes në drejtësi për personat LGBTI në vendin tonë përmes bashkëpunimit me institucionet, Grupit parlamentar ndërpartiak për LGBTI në Kuvendin e RMV-së dhe bashkësinë ndërkombëtare.

Përfaqësimi kryesisht ishte drejtuar kah miratimi i Ligjit të ri për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, i cili për herë të parë shprehimisht e ndalon diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, kurse zvarritej në labirintet procedurale të Kuvendit deri në muajin maj, kur edhe përfundimisht hyri në fuqi. Një pjesë e aktiviteteve në kuadër të këtij programi ishin drejtuar në njohjen juridike të gjinisë së njerëzve transgjinorë përmes pjesëmarrjes në grupin e punës për hartimin e zgjidhjeve përkatëse ligjore, organizimit të konferencave publike, takimeve të punës me palët e interesuara dhe mbështetjen e fushatave.

Organizimi dhe zhvillimi i Paradës së parë të krenarisë, nga njëra anë ishte një përvojë tejet sfiduese, por nga ana tjetër tregoi se mund të arrihen ndryshime nëse ekziston përkushtim i vërtetë për diçka. Shteti tregoi se lirinë e grumbullimit, mbledhjes dhe shprehjes, njerëzit LGBTI mund ta praktikojnë lirshëm, kurse siguria gjatë paradës ishte konfirmim për lëvizjen e dukshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Nga ana tjetër, është e pashmangshme të mos përmendet fakti që kjo ngjarje që provokoi shikueshmëri më të madhe deri më tani te njerëzit LGBTI, ishte shoqëruar me rritje të gjuhës së urrejtjes, që për fat të keq nuk ishte sanksionuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Qendra për mbështetje LGBTI edhe në vitin 2019 vazhdoi me raportimin e rregullt mujor për gjendjen me të drejtat e njeriut të personave LGBTI në vendin tonë dhe aktivisht ka punuar edhe në njoftimin për gjendjen te organizatat dhe rjetet ndërkombëtare.





BARAZIA
GJINORE
NË SPORT

Pjesë e fushatës „16 ditë aktivizëm kundër dhunës me bazë gjinore “ ishte edhe panel-diskutimi që e organizoi Shoqata për avancimin e besimit reciprok – TAKT, në bashkëpunim me Rrjetin kombëtar kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Tema e panel-diskutimit ishte “Ngacmimi seksual i grave që merren me sport rekreativ”²², ku njëra prej bashkëbiseduesve ishte edhe përfaqësuesja e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Duke marrë parasysh se fokusi i fushatës së sivjetshme ishte ngacmimi seksual, diskutantët, njëherit sportiste profesionale dhe rekreative, i ndanë përvojat e tyre personale, duke theksuar se tema për dhunën seksuale dhe ngacmimin seksual të grave që merren me sport nuk është aktualizuar sa duhet në vendin tonë. Në RMV akoma mungojnë hulumtime në këtë temë, njëherit nuk ekziston as rregullativë ligjore dhe sistem për mbrojtjen e vajzave dhe grave që praktikojnë sport dhe që janë viktimat të ngacmimit dhe dhunës seksuale. Shoqata TAKT e ka aktualizuar këtë çështje dhe sfidën me dhunën me bazë gjinore në sport, e cila shumë rrallë përmendet dhe akoma konsiderohet si një temë tabu në vendin tonë. Publiku sportiv dhe më gjerë, aspak nuk është i informuar për këtë sfidë me të cilën përballen sportistet, madje në disa raste as vetë sportistet nuk mund të identifikojnë se kanë qenë viktimat të ndonjë forme të ngacmimit dhe dhunës seksuale.

Duke marrë në konsideratë përpjekjet e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut për barazinë gjinore në të gjitha sferat e jetës

²² <https://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/06-12-2019-panel-diskusija-seksualno-voznemiruvane-na-zheni-koi-se-zanimavaat-so-rekreativen-sport/>

shoqërore, si dhe aktualizimin e çështjes së barazisë gjinore në sport përmes platformës feministe „Meduza“ që nga fillimet e saj, në dhjetor të vitit 2019 Komiteti i Helsinkit filloi edhe bashkëpunimin joformal me shoqatën TAKT. Në periudhën në vijim, të dy organizatat përmes mbështetjes së ndërsjellë dhe shkëmbimit të ekspertizës do të punojnë në përfaqësimin e të drejtave të grave në sport dhe parandalimin dhe mbrojtjen e sportisteve nga dhuna me bazë gjinore.

Prandaj, përmes bashkëpunimit me TAKT, Komiteti i Helsinkit në periudhën në vijim do të përkushtohet të rrisë ndërgjegjësimin për rëndësinë e barazisë gjinore në sport, si dhe të kryejë hulumtime në lidhje me këtë temë në mënyrë që t'i përgjigjet si duhet problemit ose të përgatisë masa dhe zgjidhje përkatëse. Në këtë drejtim, konsiderojmë se ka nevojë që të krijohen rregullore dhe strategji për t'u ballafaquar me dhunën me bazë gjinore në të gjitha federatat kombëtare dhe klubet sportive, si dhe të krijohen mekanizma mbrojtës që do t'i mbronin gratë dhe vajzat që merren me sport, si në nivel rekreativ ashtu edhe në atë profesional. Ky problem duhet të trajtohet si urgjent në kuadër të Strategjisë së re për sport si dhe në të gjitha dokumentet interne të subjekteve sportive. Njëherit, përveç masave për t'u ballafaquar me dhunën me bazë gjinore në sport, Strategjia e re për sport, në projekt-tekstin e së cilës barazia gjinore është vënë si një prioritet i veçantë, duhet që të përfaqësohen edhe disa segmente të

rëndësishme, si janë përqindja e detyrueshme e pjesëmarrjes së grave në organet drejtuese dhe përfaqësimi i tyre të pozita të rëndësishme drejtuese, afirmimi i

sportit femëror, mbështetja e barabartë financiare sportit femëror dhe mashkullor dhe përfaqësimi i barabartë i sportit femëror në hapësirat mediale.

RAPORT VJETOR I KOMITETIT TË HELSINKIT PËR TË
DREJTAT E NJERIUT PËR VITIN 2019



**KOMITETI I
HELSINKIT PËR
TË DREJTAT E
NJERIUT**